

**LIGJ**  
**Nr. 121/2015**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT AFATGJATË TË ZHVILLIMIT TË FORCAVE TË**  
**ARMATOSURA 2016-2025**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Miratohet Plan i Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2016-2025, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

**Neni 2**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore, të nevojshme për zbatimin e këtij plani.

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.11.2015

**KRYETARI**  
**Ilir Meta**

**PLANI AFATGJATË I ZHVILLIMIT TË FA 2016-2025**

**KREU I**  
**TË PËRGJITHSHME**

Plan i Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2016-2025 (PAZHFA 2016-2025) përkthen objektivat e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, Strategjisë Ushtarake, skenarët e rishikimit strategjik të mbrojtjes 2013, si dhe konceptin strategjik të NATO-s në kapacitete ushtarake, duke tentuar plane orientuese në pikëpamje të kohës dhe burimeve të disponueshme.

Ky dokument përcakton drejtimit e zhvillimit të Forcave të Armatosura (FA) dhe orienton ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për përmbushjen e misionit kushtetues dhe mbrojtjen kolektive mbi bazën e burimeve, në harmoni me Sistemin e Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s. Në të përshkruhen mjetet, me të cilat FA do të përmbushin objektivat ushtarakë të përcaktuar në Strategjinë Ushtarake dhe që rrjedhin nga Strategjia e Sigurisë Kombëtare.

Me miratimin e PAZHFA 2016-2025, komandat e forcave, Komanda Mbështetëse dhe Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes do të hartojnë planet e tyre respektive të detajuara, ndërsa drejtoritë në Shtabin e Përgjithshëm të FA do të hartojnë planet mbështetëse me projektet përkatëse.

**1.1 Supozimet**

Hartimi i PAZHFA 2016-2025 është bërë duke u bazuar në supozimet e mëposhtme:

-Kushtetua e Republikës së Shqipërisë, Strategjia e Sigurisë Kombëtare dhe Strategjia Ushtarake nuk do të ndryshojnë në periudhën 5-10-vjeçare, po ashtu edhe misioni kushtetues dhe angazhimet e FA në operacione, misione dhe detyra;

-Aleanca e NATO-s do të vijojë të luajë rolin e saj në kuadrin e sigurisë kolektive. Roli, detyrat dhe kërkesat për kapacitete në këtë kuadër nuk do të ndryshojnë dukshëm, por presioni për përmbushjen e detyrimeve për zhvillimin e kapaciteteve në kuadër të Aleancës do të rritet;

-Situata globale dhe rajonale e sigurisë nuk do të ndryshojë në mënyrë radikale në periudhën 2016-2025;

-Personeli i FA nuk do të ndryshojë në termat sasiorë (8500 veta), por do të ketë përmirësim në cilësi;

-Buxheti i mbrojtjes nuk do të ulet poshtë nivelit aktual, por do të rritet gradualisht deri në nivelin e kërkuar prej RSM dhe do të përdoret me efektivitet;

-Angazhimi i FA në operacione brenda dhe jashtë vendit do të shoqërohet me rritje të kostos;

-Përdorimi i burimeve të mbrojtjes në FA do të bëhet në mënyrë të balancuar ndërmjet tri kategorive kryesore të shpenzimeve (për personelin, për operacionet dhe mirëmbajtjen, si dhe për investimet), prej të cilit deri në 20 për qind mund të shpenzohet për investime dhe pajisje e armatim;

- Gjetjet e Dokumentit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes (RSM-2013) do të jenë aktuale.

## KREU II

### PAZHFA NË KUADRIN E DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

#### 2.1 Dokumentet kryesore strategjike

Hartimi i PAZHFA 2016-2025 është bazuar në dokumentet kryesore të sigurisë kombëtare, (Kushtetuta e RSH-së, ligji nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Strategjia e Sigurisë Kombëtare (SSK), Strategjia Ushtarake (SU) dhe Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes (RSM), dhe të Aleancës (Koncepti Strategjik dhe Paketa e Objektivave të Kapaciteteve të NATO-s).

Kushtetuta e RSH-së përcakton misionin: “Forcat e Armatosura sigurojnë pavarësinë e vendit, si dhe mbrojnë tërësinë territoriale dhe rendin e tij kushtetues”.

Strategjia e Sigurisë Kombëtare përcakton detyrimet e shtetit për garantimin e sigurisë dhe lirisë, të cilat paraqiten në formën e objektivave strategjikë. SSK përshkruan rreziqet e sigurisë kombëtare dhe detyrimet e institucioneve për përballimin e tyre.

Strategjia Ushtarake e RSH-së është dokumenti kryesor, i cili përkthen objektivat politikë të përcaktuar në SSK në objektiva ushtarakë. Në funksion të mjedisit të sigurisë, përcaktohet roli, misioni dhe detyrat e FA, si një prej instrumenteve kryesore të fuqisë kombëtare. Në përmbushje të këtyre detyrimeve, FA duhet të zhvillojë kapacitetet të nevojshme për përballimin e rreziqeve të parashikuara dhe përmbushjen e misionit e të detyrave.

Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes 2013 u hartua bazuar në analizën e ndikimit të rreziqeve aktuale dhe të pritshme në sigurinë e vendit. Në të përcaktohen burimet (njerëzore, financiare, materiale) që i nevojiten FA për të përballuar, minimizuar dhe eliminuar rreziqet mbi sigurinë dhe ekonominë e vendit, si strukturë e vetme apo edhe në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore. Rekomandimet e RSM-së dhe skenarët e saj kanë qenë esenciale në planifikimin e Forcës, të reflektuar në këtë dokument.

Përveç dokumenteve të rëndësishme kombëtare, PAZHFA 2016-2025 merr në konsideratë edhe Konceptin Strategjik të NATO-s me detyrimet në kuadër të mbrojtjes kolektive, të përfshira në paketën e objektivave të kapaciteteve.

Koncepti Strategjik i NATO-s, krahas kapaciteteve të nevojshme për t'i rezistuar një sulmi të armatosurii deri në aktivizimin e nenit 5 të mbrojtjes kolektiveiii, u kërkon vendeve aleate zhvillimin e kapaciteteve për përmbushjen e nivelit të ambicies së Aleancës (2+6)iv.

Kapacitetet për NATO-n u kërkojnë vendeve nëpërmjet paketës së objektivave të kapaciteteve, që është dokumenti që përcakton kapacitetet që duhet të zhvillojë FA për të qenë të ndërveprueshme dhe të afta për t'iu përgjigjur kërkesave të Aleancës.

#### 2.2 Nevoja për PAZHFA

Planifikimi Afatgjatë i Zhvillimit të FA 2016-2025 vjen si nevojë e rishikimit të herëpashershëm të tij dhe në vijimësi të zbatimit të dokumenteve strategjike, të tilla si Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Ushtarake, Koncepti i Ri Strategjik i NATO-sv, përfundimet e Samitit të Uellsit, Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes së RSH 2013 etj.

Zgjerimi i spektrit të misioneve dhe detyrave që përmbushin FA, rritja e kontributeve në operacione, si brenda vendit dhe në kuadër të Aleancës, rritja e ndikimit të teknologjisë së informacionit dhe aktorëve qeveritarë e joqeveritarë të përfshirë, si dhe kufizimet buxhetore do të kërkojnë që për 10 vitet e ardhshme të shfrytëzohen me efektivitet burimet për zhvillimin e kapaciteteve dhe transformimin e FA. Hartimi i këtij plani kërkohet edhe nga nevoja e harmonizimit të Planifikimit të FA me Sistemin e Planifikimit të NATO-s.

#### 2.3 Metodologjia e hartimit të PAZHFA 2016-2025

Procesi i hartimit të PAZHFA 2016-2025 është drejtuar nga një grup pune i përbashkët i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe është produkt i bashkëpunimit dhe kontributit të ekspertëve më të mirë të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA, komandave të forcave dhe atyre mbështetëse.

Hapi i parë në hartimin e PAZHFA 2016-2025 ishte vlerësimi i misioneve dhe detyrave që FA duhet të përballojë dhe identifikimi i boshllëqeve në kapacitetet ekzistuese. Vlerësimi i nevojave për kapacitete u bë

duke konsideruar dokumentet kryesore strategjike: SSK, SU, si dhe paketën e objektivave të kapaciteteve.

Më pas, për të krijuar një pamje të kapaciteteve të nevojshme të FA, u analizuan dhe vlerësuan kërcënimet ndaj vendit tonë dhe skenarët e rreziqeve sipas Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes. Skenarët e rreziqeve dhe kërcënimeve, megjithëse ilustronë se nuk ka asnjë rrezik për një sulm ushtarak në shkallë të gjerë kundër vendit tonë, evidentojnë nevojën për kapacitete të afta që të parandalojnë e përballojnë çdo agresion deri në aktivizimin e nenit 5 të Aleancës.

Lista e skenarëve të planifikimit të FA sipas RSM

- Cenimi i integritetit territorial/sovrانيتit;
- Dhënie e ndihmës në rast fatkeqësie;
- Vendosje e paqes;
- Shpërthim i municioneve të tepërta;
- Cenim i ligjshmërisë në det (pirateri /gjueti/kontrabandë);
- Sulm terrorist;
- Zhvendosje masive e njerëzve/refugjatëve;
- Tërmet;
- Mot ekstrem;
- Aksident industrial;
- Aksident transporti me përmasa të mëdha;
- Kërcënimet kibernetike.

Bazuar në skenarët e mësipërm, u krye analiza funksionale, e cila identifikoi kapacitetet ushtarake të nevojshme për mbrojtjen.

Në hapin tjetër, kapacitetet e nevojshme u krahasuan me kapacitetet ekzistuese për të identifikuar boshllëqet sasiore dhe cilësore. Vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese dhe të nevojshme krijoi një pamje të përgjithshme të situatës aktuale dhe të synimit të dëshiruar. Pas këtij hapi u bë ndarja sipas prioriteteve e kapaciteteve të nevojshme, duke u nisur nga faktorët e përdorueshmërisë së kapaciteteve dhe minimizimit apo peshës së rrezikut, si dhe konsiderimi i kostos së pritshme, duke u fokusuar në kapacitetet e përdorshme, fleksible (shumëpërdorimshme) dhe të ndërveprueshme.

Faza e fundit e programimit përcaktoi nivelet në të cilat duhet të zhvillohet çdo kapacitet dhe nevojat për burimet në drejtim të financës, personelit, materialeve dhe kohës.

Programimi evidentoi tri kategori të kapaciteteve

Nisur jo vetëm nga rëndësia e kapaciteteve në përmbushjen e misionit dhe detyrave, por edhe nga burimet në dispozicion, kapacitetet u kategorizuan në tri grupe:

- *Kapacitetet që janë të nevojshme për mbrojtjen kombëtare, por janë shumë të kushtueshme për vendin tonë dhe mund të arrihen vetëm në bashkëpunim me NATO-n dhe aleatët.* Në rastin e FA, kapacitete të tilla janë, për shembull, mbrojtja raketore, avionët luftarakë, helikopterë sulmi e transporti strategjik etj.

- *Kapacitetet që i nevojiten FA, por realizimi i të cilave është i pamundur në afatim kohor të 10 viteve të ardhshme.* Këto kapacitete janë identifikuar gjatë vlerësimit dhe është analizuar fizibiliteti i tyre gjatë programimit, të tilla si sistemet dhe platformat e lëshimit të raketave me një rreze deri në 70 kilometra dhe sistemet e raketave tokë-det të nevojshme për shkatërrimin objektivave detarë sipërfaqësorë etj. Zhvillimi i kapaciteteve të tilla mund të konsiderohet pas 2025 ose në rast se disa nga projektet në zhvillim do të kenë kosto konsiderueshëm më të ulët sesa buxheti i planifikuar fillimisht.

- *Kapacitetet që janë të nevojshme për mbrojtjen kombëtare dhe zhvillimi i të cilave mund të nisë ose të realizohet brenda 10 viteve të ardhshme.* Këto kapacitete formojnë planin e zhvillimit të FA deri në vitin 2025.

### KREU III

#### PARIMET E HARTIMIT TË PAZHFA

##### 3.1 Parimet bazë

PAZHFA 2016-2025 nevojitet për zhvillimin e një force të pajisur dhe të gatshme, efektive dhe në shërbim të vendit e Aleancës. Ky është PAZHFA i parë i Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s, i cili e konsideron sigurinë dhe mbrojtjen e Shqipërisë si pjesë e mbrojtjes kolektive të Aleancës, me përfitimet dhe detyrimet përkatëse që rrjedhin prej saj.

FA do të zhvillojë kapacitetet e nevojshme për të përmbushur misionin dhe detyrimet kushtetuese, ligjore dhe nivelin e ambicies (NiA), të përcaktuar në Strategjinë Ushtarake. Kapacitetet do të zhvillohen të orientuara nga parimi i “një grupimi të vetëm forcash” (*Single Set of Forces*), të afta për të garantuar përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe detyrimeve për mbrojtjen kolektive.

Forcimi dhe rritja e kapaciteteve ushtarake është domosdoshmëri për mbrojtjen kombëtare. Megjithatë anëtarësimi në NATO i ofron Shqipërisë garanci të besueshme brenda mbrojtjes kolektive, themeli i mbrojtjes kombëtare të Shqipërisë mbështetet në aftësitë dhe resurset kombëtare.

PAZHFA 2016-2025 bazohet në kapacitete. Në themel të planifikimit është zhvillimi i kapaciteteve të nevojshme për përmbushjen e misionit kushtetues dhe detyrimeve të FA në kuadër të Aleancës. Metodologjia e planifikimit të bazuar mbi kapacitetet mbështet zhvillimin e një force të armatosur bazuar në aftësitë e saj. Kapacitetet përcaktohen nga cilësia e personelit, organizimit, trajnimit, pajisjes, drejtimit, mbështetjes, motivimit, infrastrukturës dhe ndërveprimit të saj me aleatët.

Zhvillimi i kapaciteteve të forcës së ardhshme do të arrihet duke synuar raport të drejtë kosto–efektivitet, menaxhim të mirë, si dhe qasje të balancuar të shpenzimeve për zërat e personelit, operacionet e mirëmbajtjes dhe modernizimin e sistemeve, pajisjeve dhe infrastrukturës.

Sistemi i planifikimit bazuar në kapacitete mbështetet në parimet:

*Nga lart-poshtë* - Planet për zhvillimin e kapaciteteve do të hartohen në përmbushje të prioriteteve strategjike të RSH, në mënyrë të veçantë, në misionet, detyrat dhe rolet që Këshilli i Ministrave kërkon të përmbushen nga FA, të papriturat, rreziqet dhe kërcënimet që do të përballohen dhe neutralizohen prej tyre.

Ndërtimi progresiv i kapaciteteve - Kjo qasje kërkon ndërtimin e blloqeve specifike të kapaciteteve nga poshtë-lart, sipas prioriteteve. Kjo qasje përpiqet të qartësojë se si do të realizohen në mënyrë më efektive detyrat, sipas planeve operacionale, duke shfrytëzuar kombinimin efektiv të kapaciteteve të synuara dhe atyre ekzistuese.

*Efektiviteti i shpenzimeve* - Efektiviteti i shpenzimeve bazohet në analizën e kostos përgjatë ciklit jetësor për çdo kapacitet dhe krahasimin e tyre me përfitimet.

*Vlerësimi afatgjatë* - Duke qenë se vonesa, zakonisht prej disa vitesh, prej planifikimit deri në futjen në shërbim të kapacitetit, është e pashmangshme, nevojitet vlerësim afatgjatë. Pas hyrjes në shërbim, kapacitetet do të shfrytëzohen për dekada të tëra, prandaj planifikimi duhet të jetë afatgjatë dhe të konsiderojë ciklin e tyre jetësor, shpenzimet operacionale dhe të mirëmbajtjes, potencialin për përmirësime e përditësime dhe mundësitë për blerje të reja.

*Fleksibiliteti* – Pavarësisht se vlerësimi dhe planifikimi afatgjatë është i nevojshëm për planifikim efektiv, zhvillimi i kapaciteteve duhet të konsiderojë mundësinë për t'u përshtatur brenda një kohe të shkurtër me ndryshimet e programeve të buxhetimit apo mjedisit operacional.

*Zhvillimet konceptuale* – Doktrina dhe koncepte të reja duhet të zhvillohen paralelisht me zhvillimin e kapaciteteve.

PAZHFA 2016-2025 do të rishikohet çdo 4 vjet ose sa herë që do të ketë ndryshim të ndjeshëm në faktorët me ndikim në sigurinë e vendit.

### 3.1.1 Misioni dhe detyrat e FA

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në përmbushje të misionit kushtetues, si dhe përcaktimeve të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, në lidhje me rolin e shtuar në shërbim të qytetarëve dhe në mbështetje të autoriteteve civile, do të zhvillojnë kapacitete të afta për të siguruar pavarësinë e vendit, mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe rendin kushtetues të vendit, në bashkëveprim me forcat aleate, mbrojtjen dhe mbështetjen e popullsisë e të autoriteteve civile në kohë paqeje, krize e lufte, të kontribuojnë për mbrojtjen kolektive, në kuadër të nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit, vii si dhe pagën e sigurinë në rajon e më gjerë.

FA janë organizuar si strukturë e bashkuar me përbërje të Forcës Tokësore, Forcës Detare, Forcës Ajrore dhe atyre mbështetëse. Përdorimi operacional i FA bazohet në konceptin e organizimit të grupimeve operacionale për detyrë (*task force*), i cili është bashkim kapacitetesh, sipas natyrës së misionit, më vete, në kuadër të NATO-s apo në koalicione të tjera.

*Në kuadër të përmbushjes së misionit, FA realizojnë:*

- Detyra për mbrojtjen, garantimin e sovranitetit dhe pavarësisë, mbrojtjen e integritetit territorial të vendit dhe detyrimeve në kuadër të Aleancës.

- Detyra në mbështetje të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, nëpërmjet pjesëmarrjes në operacionet e NATO-s jashtë nenit 5, në përgjigje të krizave, në misionet e BE, OKB, OSBE; veprimtari të tjera të lidhura me armëkontrollin, mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, ofrimin e ndihmave humanitare dhe konsolidimin e besimit e të sigurisë.

- Detyra në kohë paqeje për ndërtimin e kapaciteteve paralajmëruese dhe zbuluese për rreziqet potenciale dhe kërcënimet, kontrollin e hapësirës detare e ajrore, operacionet e kërkim-shpëtimit, mbrojtjen e objekteve strategjike, në shërbim të qytetarëve dhe në mbështetje të autoriteteve civile, mbështetjen e popullsisë në rast

fatkeqësish natyrore, aksidenteve industriale dhe krizave ekologjike, mbështetjen e strukturave të tjera në neutralizimin e grupeve terroriste, ekstremiste e kriminale, si dhe për mbështetjen sipas ligjit të autoriteteve lokale dhe qendrore dhe organizatave të tjera qeveritare.

### 3.2 Struktura

Forcat e Armatosura janë organizuar, përgatiten dhe funksionojnë sipas principeve themelore të ndërtimit e funksionimit të organizmave ushtarakë në shoqëritë demokratike që, pavarësisht madhësisë, janë të afta të përmbushin misionin e tyre.

Struktura organizative e FA është zhvilluar dhe zbatuar sipas rekomandimeve të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes (RSM) 2013, të cilat përcaktojnë se si do të zhvillohen FA në të ardhmen dhe madhësinë e numrin e personelit. Ambiciet e FA-së, pritshmëria, kërkesat e nevojat operationale që shtrohen para tyre kërkojnë një organizim, menaxhim e funksionim efektiv, i cili mund të arrihet nëpërmjet një strukture organizative funksionale dhe të thjeshtë.

Në fillim të vitit 2016, numri i personelit do të jetë 8500 veta. Riorganizimi i përmbushur tashmë synon mbajtjen dhe zhvillimin e kapaciteteve operationale kritike të FA, duke mos ndryshuar strukturën, por nëse do të vlerësohet e nevojshme, duke e korrigjuar. Kapacitetet e zhvilluara nga forcat do të vihen në dispozicion të operationeve që do të ndërmerren brenda vendit, në kuadër të Aleancës e koalicioneve të tjera apo edhe të operationeve ndërinstitutionale në nivel kombëtar. Në këtë kuadër, struktura e FA do të synojë një grupim më të mirë të njërive ushtarake, duke i integruar ato nën komandat kryesore përkatëse, bazuar në natyrën e veçoritë e tyre, si dhe në lehtësinë për t'i përdorur me efikasitet në momentin e kërkuar. Kështu, trupat e luftimit dhe ato të mbështetjes së luftimit organizohen nën komandat kryesore, çka do të sigurojë jo vetëm një lidhje organizative logjike midis këtyre dy grupeve të forcave, por do të krijojë kushte për trajnim të përbashkët, pajisje dhe zhvillim nën të njëjtin koncept.

FA, sipas Kushtetutës, organizohen në Forca Tokësore, Detare dhe Ajrore. Në realizimin e misionit dhe detyrave, komandat e forcave mbështeten nga Komanda Mbështetëse (KM), Komanda e Doktrinės dhe Stërvitjes (KDS) dhe strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA.

Struktura e FA parashikon një sistem komandimi e drejtimi operational më të thjeshtë e më të zhdërvjellët. Shtabi i Përgjithshëm i FA përbën strukturën organizative më të lartë ushtarake në Forcat e Armatosura dhe kryen komandën unike në Forcat e Armatosura. Ai vepron si shtab i bashkuar i forcave tokësore, detare, ajrore dhe strukturave mbështetëse.

Në raport me përfituesit e kontributeve operationale, si në planin kombëtar, ashtu dhe në atë ndërkombëtar, FA luajnë rolin e gjeneruesit të forcës (*force provider*). Sipas këtij koncepti, FA krijojnë dhe mbajnë në gatishmëri kapacitete operationale ushtarake për t'i vënë në dispozicion të përdoruesve potencialë, kombëtarë apo ndërkombëtarë, të cilët kryejnë funksionin e përdoruesit të forcës (*force user*). Në kuadër të brendshëm të vetë Forcave të Armatosura, komandat e forcave, njërive dhe strukturave të tjera të FA kryejnë funksionin e gjeneruesit të forcës (*force provider*) dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA në funksionin e përdoruesit të forcës (*force user*). Angazhimi i FA në operatione të të gjitha llojeve realizohet përmes grupeve operationale (*task force*).

Organizimi strukturor i FA do të mundësojë përmirësimin e raportit mes forcave operationale dhe atyre të mbështetjes, raportet mes oficerëve, nënoficerëve e ushtarëve, por edhe midis gradave të çdo kategorie personeli ushtarak në interes të një piramide të rregullt dhe funksionale në krahasim me madhësinë e forcës së armatosur.

#### 3.2.1 Prioritetet e zhvillimit të FA

##### 1. Forca Tokësore:

###### 1.1 Batalioni i Dytë i Këmbësores;

###### 1.2 Batalioni i Forcave Speciale.

##### 2. Forca Ajrore:

###### 2.1 Baza Ajrore Farkë;

###### 2.2 Kapacitete të kërkim-shpëtimit;

###### 2.3 Qendra e Vëzhgimit Ajror dhe Qendra e Kontroll-Raportimit.

##### 3. Forcat Detare:

###### 3.1 Flotilja Detare;

###### 3.2 Qendra e Vëzhgimit Detar.

## KREU IV KAPACITETET E FA

Kapacitet, në kontekstin e mbrojtjes, konsiderohet aftësia për të arritur një efekt të dëshiruar operacional në një mjedis specifik, brenda një kohe të caktuar dhe për ta mbajtur këtë efekt për një periudhë të dhënë.

Kapaciteti ushtarak gjenerohet nga kombinimi i elementeve themelore të kapaciteteve të mbrojtjes, të cilat kategorizohen në: doktrinë, organizim, trajnim, personel, materiale, lidhshmëri, infrastrukturë dhe ndërveprim. Kapaciteti llogaritet si sinergia e krijuar nga mënyra se si kombinohen dhe aplikohen këto elemente.

Kapacitetet e FA do të kategorizohen sipas misionit dhe detyrave në kapacitete të luftimit, të mbështetjes së luftimit, mbështetjes me shërbime të luftimit, kërkim-shpëtimit, emergjencave civile dhe në kapacitete të arsimimit dhe stërvitjes.

### 4.1 Kapacitetet e luftimit

*Kapacitetet e luftimit* përfaqësojnë aftësitë e FA për të kryer operacione luftarake dhe joluftarake. Këto kapacitete përfshijnë njësitë e luftimit, të cilat krijohen, organizohen, pajisen dhe stërviten për zhvillimin e operacioneve, për të siguruar sovranitetin dhe integritetin e vendit deri në aktivizimin e burimeve të tjera kombëtare apo aktivizimin e nenit 5 të Aleancës. Bazën e kapaciteteve të luftimit e përbëjnë njësitë e luftimit të Forcës Tokësore (batalionet e luftimit), ndërsa ato të forcave të tjera do të zhvillohen në kohë të përshtatshme, në përputhje me nivelin e rrezikut ndaj sigurisë kombëtare dhe detyrimeve ligjore.

Në përmbushje të misionit dhe detyrave luftarake do të angazhohen të gjitha kapacitetet ushtarake të FA. Kapaciteti themelor i deklaruar për *mbrojtjen kolektive*, në kuadër të Aleancës, sipas detyrimeve në procesin e planifikimit të mbrojtjes të NATO-s, është një “Grup-Batalion i Këmbësorisë”, me angazhim gjashtë muaj deri në një vit, pa rotacion të mëtejshëm, të konfiguruar sipas misionit konkret.

Kapacitetet e FA për pjesëmarrje në operacione në përgjigje ndaj krizave, jashtë nenit 5 (NA5CRO), po sipas konceptit të “një grupimi të vetëm forcash” për NATO/BE/OKB, arrijnë deri në angazhimin e tre kompanive njëherësh në operacione me rotacion të vijueshëm. Pjesëmarrja mund të bëhet edhe me kapacitete të specializuara “*Niche*” viii, grupe të forcave speciale, si dhe ekspertë (civilë dhe ushtarakë) trajnues, këshillues, koordinatorë dhe vëzhgues.

Sasia e përgjithshme e autorizuar e personelit të kapaciteteve të luftimit do të jetë deri në një e treta e numrit të përgjithshëm të personelit të FA dhe do të përbëhet nga:

- Batalioni I i Këmbësorisë;
- Batalioni II i Këmbësorisë;
- Batalioni III i Këmbësorisë;
- Batalioni Komando;
- Batalioni i Forcave Speciale;
- Flotilja Detare;
- Baza Ajrore Farkë.

### 4.2 Kapacitetet e mbështetjes së luftimit

Kapacitetet e mbështetjes së luftimit përfaqësojnë aftësitë e FA për të mbështetur operacionet, në përmbushje të misionit dhe detyrave. Ato realizohen nga njësitë e mbështetjes së luftimit dhe njësitë e mbështetjes me shërbime të luftimit. Sasia e përgjithshme e forcave të mbështetjes do të jetë rreth dy të tretat e numrit të përgjithshëm të FA.

*Kapacitetet e mbështetjes së luftimit* përbëhen nga kapacitetet e mbështetjes me fuqi zjarri dhe kapacitetet që ofrojnë ndihmë operationale të elementeve të luftimit, të tilla si kapacitetet e inteligjencës, sigurisë, mbrojtjes nga armët e dëmtimit në masë, xhenios luftuese dhe komandim-kontrollit e komunikimit.

Në kapacitetet aktuale dhe ato që do të zhvillohen në periudhën e mbuluar nga PAZHFA 2016-2025 përfshihen:

- Kapacitetet e komandim-kontrollit për MM dhe SHP;
- Kapacitete të mbrojtjes prej armëve të dëmtimit në masë;
- Kapacitetet xheniere (Kompani Xhenio në mbështetje të luftimit);
- Kapacitete të mbështetjes me zjarr (Bateria e mortajave);
- Kapacitete të mbrojtjes ajrore;

- Batalioni i Xhenios dhe Kompania e Ndërtimit;
- Kapacitet për asgjësimin e municioneve të rrezikshme (EOD);
- Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit (ASNI);
- Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM);
- Qendra e Kombëtare e Zhytjes;
- Qendra e Vëzhgimit Detar (QVD);
- Qendra e Vëzhgimit Ajror (QVA).

Kapacitetet e mbështetjes me shërbime të luftimit përfaqësojnë aftësitë e FA për të mbështetur operacionet, në përmbushje të misionit dhe detyrave. Ato realizohen nga njësitë dhe kapacitetet e mbështetjes me shërbime të luftimit, të cilat sigurojnë mbështetjen e përgjithshme për të gjitha FA. Në këto kapacitete hyjnë kapacitetet e furnizimit, transportit, mirëmbajtjes, kujdesit shëndetësor, kujdesit psikologjik dhe të administrimit.

Në kapacitetet aktuale dhe ato që do të zhvillohen në periudhën e mbuluar nga PAZHFA 2016-2025 përfshihen:

- Batalioni i Mbështetjes së SHP;
- Batalioni i Furnizimit;
- Batalioni i Transportit;
- Policia Ushtarake (PU);
- Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU);
- Toga e Bashkëpunimit Civil-Ushtarak (CIMIC);
- Qendra Shëndetësore Rol 2/Spitali Ushtarak;
- Shërbimi Meteorologjik Ushtarak;
- Shërbimi Hidrografik;
- Qendra e Vëzhgimit Ajror (QVA);
- Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD);
- Sistemi i Automatizuar i Informacionit Logjistik;
- Qendra e Menaxhimit të Materialeve dhe Laboratori Qendror i FA;
- Qendra e Riparimit dhe Mirëmbajtjes së Teknikës së FA.

Kapacitetet për përballimin e emergjencave civile përfaqësojnë aftësitë e FA, të cilat do të angazhohen në operacione të ndryshme për sigurimin e mbështetjes ndaj autoriteteve qendrore dhe lokale për përballimin e emergjencave civile brenda vendit dhe në nivel rajonal. Këto kapacitete do të mbështesin një situatë emergjente të vetme me angazhimin e një njësie deri në dy batalione të përforcuara ose e dy situatave emergjente të njëkohshme me angazhimin e dy njësive deri në nivel batalioni të përforcuar. Kjo mbështetje për autoritetet civile qendrore dhe lokale kryhet kur burimet shtetërore janë përdorur dhe kapacitetet e tyre janë të pamjaftueshme.

Në kapacitetet aktuale dhe ato që do të zhvillohen apo përmirësohen në periudhën e mbuluar nga PAZHFA 2016-2025 përfshihen:

- Batalioni i Mbështetjes Rajonale;
- Baza Ajrore Farkë;
- Batalioni i Xhenios;
- Batalioni i Forcave Speciale;
- Batalioni i Furnizimit;
- Batalioni i Transportit;
- Kompania e Kimisë;
- Qendra e Menaxhimit të Materialeve dhe Laboratori Qendror i FA;
- Kapacitete detare (Flotilja Detare);
- Qendra e Zhytjeve;
- Shërbimi Hidrografik i FD;
- Kapacitete ajrore (Baza Ajrore Farkë);
- Shërbimi Meteorologjik Ushtarak i Forcës Ajrore;
- Qendra e Riparimit dhe Mirëmbajtjes së Teknikës së FA;
- Qendra Shëndetësore Rol 2/Spital Ushtarak i FA;
- Seksioni i Bashkëpunimit Civil-Ushtarak (CIMIC).

Kapacitetet e kërkim-shpëtimit përfaqësojnë aftësitë e FA për të mbështetur operacionet e kërkim-shpëtimit dhe përbëhen nga:

- Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit, (QKKSH),
- Batalioni i Mbështetjes Rajonale;
- Kompania e Kërkim-Shpëtimit;
- Flotilja Detare;
- Baza Ajrore në Farkë;
- Batalioni i Xhenios;
- Kompania e Kimisë.

Kapacitetet e arsimit dhe stërvitjes përfaqësojnë aftësitë e FA për të mbështetur arsimimin, edukimin, përgatitjen dhe trajnimin e gjithë personelit të FA dhe përbëhen nga:

- Akademia e Forcave të Armatosura;
- Qendra e Doktrinës dhe Kërkimit;
- Akademia e Nënoficerëve;
- Shkolla e Trupës dhe Qendra e Stërvitjes Individuale;
- Qendrat Stërvitore në FT, FD, FAj dhe KM;
- Qendra e Simulimit Konstruktiv;
- Poligoni Kombëtar në Bizë.

### **4.3 Kapacitetet e komandimit dhe kontrollit**

Për të siguruar ushtrimin e funksioneve të komandimit dhe kontrollit për përmbushjen e misionit nga drejtuesit, do të përmirësohen kapacitetet lidhur me personelin, pajisjet, komunikimin, ambientet e infrastrukturën dhe procedurat e punës për planifikimin, drejtimin, koordinimin dhe kontrollin e forcave dhe operacioneve në përmbushjen e misionit.

Fokusi i zhvillimit do të jetë në implementimin e teknologjisë në komandim-kontroll me sisteme dhe programe kompjuterike, të cilat do të rritin efektivitetin e forcave të luftimit, duke krijuar rrjetin taktik të informacionit, implementimin e sistemit të gjurmimit të forcave tona (i cili do të mundësojë komandantët e njësisë të njohin vendndodhjen e forcave) dhe modernizimin e posteve të komandimit dhe vendkomandave të reja.

Kapacitetet kritike të komandim kontrollit në FA do të sigurohen edhe përmes futjes në përdorim të programeve të posaçme dhe rrjeteve të komandim-kontrollit, të cilat sugjerojnë zgjidhjet optimale në situata të ndryshme, programit për inteligjencën, luftën elektronike dhe sensorët, programit për komunikimin taktik dhe sistemet e përbashkëta të radiove taktike.

Në objektivat e PAZHFA do të jetë edhe përmirësimi i kapaciteteve të sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit, inteligjencës (Zbulimit, informacionit dhe sigurisë), mbikëqyrjes, vëzhgimit dhe zbulimit e ndërveprimit, sistemet e luftimit, luftës elektronike dhe mbrojtjes kibernetike.

Shtabi i Përgjithshëm vepron si shtab i bashkuar i forcave tokësore, detare dhe ajrore dhe përgjigjet për përgatitjen dhe stërvitjen e përbashkët të të tre komponentëve për të gjitha detyrat e tyre, për të përballuar kërcënimet a rreziqet që kërcënojnë sigurinë në vend, programimin e mbrojtjes, në mbështetje të misioneve, operacioneve, trajnimit dhe stërvitjes, vlerësimin strategjik të kërcënimeve e të rreziqeve dhe marrjen e masave për përballimin e tyre, përgatitjen, drejtimin dhe komandimin e veprimeve ushtarake, mbështetjen logjistike, hartimin e kërkesave për zhvillimin dhe pajisjen e tri shërbimeve të FA, përdorimin e frytshëm të burimeve të mbrojtjes, për t'i bërë të ndërveprueshme dhe të afta në kryerjen e misioneve në operacione ushtarake ndërkombëtare, zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e bashkëpunimit, ndërveprimin me NATO-n dhe koordinimin e stërvitjeve të përbashkëta, zhvillimin e sistemeve të komandimit, të drejtimit, të komunikimit e të njoftimit të të dhënave në FA.

**Qendra e Bashkuar Operacionale (QBO)** është strukturë e FA, e cila mbështet Shtabin e Përgjithshëm të FA në përmbushjen e përgjegjësisë të komandimit e kontrollit në nivelin operativ-strategjik. Pas kompletimit me përfaqësues të drejtorive të SHPFA, QBO koordinon planëzimin, organizimin dhe koordinimin e operacioneve të FA, për rastet e emergjencave e situatave kritike humanitare në të gjitha format që shfaqen dhe fazat e zhvillimit të tyre, si dhe ndjek zbatimin e detyrave të planëzuara dhe të miratuara për njësitë e repartet e FA.

QBO është strukturë operacionale për monitorimin dhe mbajtjen e gjendjes së gatishmërisë dhe, në të njëjtën kohë, strukturë administrative për ndjekjen e veprimtarive të përditshme gjatë dhe pas orarit të punës.

QBO është strukturë përgjegjëse për marrjen dhe shpërndarjen e të gjitha të dhënave të situatës për strukturat e Forcave të Armatosura, duke përfshirë dhe ato kritike.

**Kapacitetet e sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit.** Një nga prioritetet kryesore të PAZHFA

2016-2025 është zhvillimi i sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit në FA. Në kohën e zhvillimeve të vrullshme të risive dhe arritjeve shkencore të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në kohë reale dhe virtuale pa kufizim distance, të sfidës së ruajtjes, mbrojtjes dhe përpunimit të informacionit nga përdoruesit legjitimë, të arritjes dhe ruajtjes së nivelit të ndërveprueshmërisë së sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit të FA me ato të NATO-s dhe vendeve aleate, do të jenë objektivat kryesorë të zhvillimit të kapaciteteve të sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit (SNI). Zhvillimi i këtyre kapaciteteve do të mundësojë dhe do të realizojë, sipas standardeve të kërkuara, mbështetjen e komandimit dhe kontrollit, jo vetëm të strukturave ushtarake, sipas niveleve të komandimit në FA, por edhe ato të deklaruara si pjesë e strukturave dhe operacioneve të udhëhequra nga NATO. Për arritjen, mbajtjen dhe përmirësimin e kapaciteteve të kërkuara, janë hartuar programe të zhvillimit dhe modernizimit të SNI-ve, të cilat kanë dhe mbështetjen financiare të ndarë në vite. Mbështetja financiare për realizimin e këtyre programeve kërkon investime të mëdha, pasi kërkesat për mbajtjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të teknologjisë së informacionit kërkojnë që të ndiqet dhe të pranohet zhvillimi i industrisë së kësaj teknologjie në kohët moderne.

**Kapacitete të zbulimit, informacionit dhe sigurisë.** Zbulimi në FA do të synojë rritjen e sasisë dhe cilësisë së produkteve të zbulimit në FA, duke iu përshtatur doktrinës dhe procedurave të Aleancës. Kjo kërkon ndërtimin e një arkitekture të qartë zbulimi, që përfshin grumbullimin e informacionit nga të gjitha burimet, përpunimin dhe nxjerrjen e produkteve të vlefshme për strukturat vendimmarrëse, operacionale dhe planëzuese. Sistemet e zbulimit, vëzhgimit dhe përnjohjes do t'i sigurojnë FA aftësitë për të mbledhur informacione të rëndësishme në kohë reale. Komandimi e kontrolli dhe sistemet e komunikimit do të sigurojnë që vendimmarrja të jetë e bazuar në informacione optimale dhe do të arrijë të gjitha nivelet e komandimit në kohë reale. Modernizimi i sistemeve të zbulimit dhe informacionit do të jetë në përputhje me kërkesat e paketës së objektivave të kapaciteteve në fushën e zbulimit, duke krijuar dhe zhvilluar konceptin e zbulimit, vëzhgimit dhe përnjohjes në nivel Joint (Joint ISR). Për këtë do të hartohen plane zhvillimi të integruara, të cilat do të përfshijnë modernizimin në të gjitha nivelet (taktik, operacional dhe strategjik), si dhe trajnimin e vazhdueshëm të personelit të zbulimit në shkollat brenda dhe jashtë vendit, me prioritet personelin, i cili do të shërbejë në pozicionet e NATO-s në funksionet e zbulimit. Kompania e Zbulimit në Forcën Tokësore do të synojë implementimin e planit të modernizimit, në përputhje me objektivin e kapaciteteve ISTAR (Intelligence, Surveillance, Targeting and Reconnaissance), duke pasur si prioritet mbështetjen e Batalionit II të Këmbësorisë.

Modernizimi i sistemit të sigurisë në planin afatshkurtër do të synojë implementimin e projektit të pajisjes së ushtarakëve me karta identifikimi. Në periudhën afatmesme dhe afatgjatë do të vijojë modernizimi i sistemeve dhe pajisjeve të sigurisë fizike, sigurisë së informacionit dhe sigurisë së rrjeteve të klasifikuara.

**Njohja e situatës detare.** Burimet e informacionit mbi situatën detare nuk do të kufizohen vetëm me ato të karakterit të mirëfilltë ushtarak, por duke integruar burimet nga autoritetet e kontrollit të zbatimit të ligjit. Bazë për grumbullimin dhe përpunimin e informacionit do të vijojë të jetë Qendra e Vëzhgimit Detar, e cila, mbështetur edhe në kërkesat e objektivave të kapaciteteve në fushën e zbulimit, do të synojë krijimin e konceptit të zbulimit, vëzhgimit dhe përnjohjes në hapësirën detare të RSH (*Intelligence, Surveillance and Reconnaissance*).

Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD), si një ndër burimet kryesore, duhet të jetë subjekt i modernizimit dhe përmirësimit, duke mbështetur ndryshimet në teknologji dhe disiplinat e reja të grumbullimit të informacionit. Nga ana tjetër, ky sistem do të jetë baza për integrimin në nivel kombëtar të informacionit mbi situatën detare në një rrjet të vetëm, me qëllim krijimin e tablosë së përbashkët detare (Recognized Maritime Picture), e cila do të shërbejë jo vetëm për strukturat e Forcës Detare dhe aktorët e tjerë në nivel kombëtar, por gjithashtu edhe për strukturat e NATO-s dhe vendet partnere, në kuadër të nismave rajonale.

Në periudhën afatshkurtër është i domosdoshëm integrimi i burimeve në një rrjet të vetëm, si dhe do të synohet modernizimi i SIVHD me radarë dhe kamera me rreze të kuqe. Në periudhën afatmesme do të synohet shtimi i burimeve dhe sensorëve të informacionit dhe në periudhën afatgjatë përmirësimi i burimeve të informacionit, në përputhje me kërkesat teknologjike të kohës.

**Njohja e situatës ajrore.** Fokusi kryesor do të jetë në ndërtimin e Sistemit të Vëzhgimit Ajror, i cili do të përmbushë kërkesat për monitorimin e hapësirës ajrore, duke synuar modernizimin me radar 3D (tredimensional) të tipit primar dhe sekondar, duke synuar rritjen e kapaciteteve të vëzhgimit të hapësirës ajrore, integrimin në Sistemin e Integruar të Vëzhgimit Kombëtar, bashkëpunimin me institucionet civile, të përfshira në SIVK, si dhe bashkëpunimin me vendet partnere, pasi vëzhgimi i vazhdueshëm i hapësirës ajrore dhe ruajtja e sovranitetit të saj përbëjnë detyra parësore të Forcave Ajrore. Pjesa minimale e këtyre

përgjegjësi është kryerja e funksionit të identifikimit të objekteve ajrore mbi Republikën e Shqipërisë dhe transmetimi i këtyre shenjave të identifikuara te Qendra e Bashkuar e Operacioneve Ajrore (CAOC Torrejon, Spanjë), si dhe te njësitë paralele fqinje të kontrollit dhe raportimit.

## KREU V

### KAPACITETET E FORCAVE TË LUFTIMIT DHE MBËSHTETJES

**5.1 Forca Tokësore (FT)** përbëhet nga Komanda dhe Shtabi, Batalioni I, II dhe III i Këmbësisë, Batalioni Komando, Batalioni i Forcave Speciale, Batalioni i Mbështetjes së Luftimit, Kompania e Mbështetjes së Shtabit dhe Qendra Stërvitore.

*FT përgatit dhe vënë në dispozicion kapacitete të luftimit tokësor, stërvitin dhe mbajnë në gatishmëri kapacitetet e kërkuara, të afta për të planëzuar dhe zhvilluar operacione tokësore, në mbrojtje të sovranitetit të vendit dhe në përmbushje të detyrimeve, në kuadër të Aleancës.*

Për plotësimin e misionit dhe përgjegjësi, FT zbaton këto detyra kryesore:

- Zhvillon kapacitete dhe i vendos në dispozicion të SHPFA, sipas urdhrave, për angazhim në operacione ushtarake ose joushtarake, brenda ose jashtë vendit;
- Planëzon dhe merr pjesë në operacione luftarake tokësore për të mbrojtur integritetin territorial të vendit në rast kërcënimesh të jashtme të karakterit ushtarak;
- Mban në gatishmëri dhe angazhon kapacitetet në operacionet humanitare në ndihmë apo për mbrojtjen e popullsisë së RSH apo mbështetjen e autoriteteve civile;
- Përgatit dhe mban në gatishmëri njësitë e FT për të marrë pjesë në operacionet e përbashkëta në kuadër të mbrojtjes kolektive;
- Kontribuon në rastet e emergjencave civile brenda vendit;
- Kryen operacione të kërkim-shpëtimit;
- Merr pjesë në operacione të drejtuara nga NATO, BE, OKB apo si pjesë e koalicioneve ndërkombëtare;
- Bashkëpunon me forcat e tjera dhe komandën mbështetëse, sipas nevojës dhe fushës së përgjegjësisë.

#### 5.1.1 Kapacitetet e Forcës Tokësore

Forca Tokësore përbën forcën kryesore të FA dhe strukturën e vetme me kapacitete për të realizuar operacione luftarake.

FT planëzon dhe zhvillon një spektër të gjerë misionesh nga ruajtja e infrastrukturës kritike, ndihma në rastet e fatkeqësive humanitare, demonstrimi i forcës e deri në zhvillimin e operacioneve tokësore luftarake dhe joluftarake. Për këtë, FT do të krijojë, do të zhvillojë dhe do të konsolidojë kapacitetet dhe aftësitë operacionale të nevojshme për të plotësuar misionin dhe detyrat.

**Batalionet e këmbësisë.** FT ka në përbërje të saj tre batalione të këmbësisë, me përmasa të përafërta në pajisje dhe personel. Këto batalione zotërojnë kapacitetet për të kontribuar në përmbushjen e misionit dhe të gjitha detyrave të FT si në kohë paqeje, krize dhe lufte.

Batalionet zotërojnë dhe do të përmirësojnë kapacitetet për të zhvilluar të gjitha llojet e operacioneve kundër forcave të lehta të kundërshtarit, në çdo lloj terreni dhe kushti klimatik, ditën e natën, në mjedise të ndotura nga ADM. Po ashtu, do të mund të veprojnë edhe kundër forcave të rënda të armikut në terrene të vështira, ku zvogëlohen avantazhet e mjeteve të blinduara dhe kufizohet lëvizshmëria e mjeteve të armikut.

Batalionet do të pajisen me mjete të vëzhgimit natën, për të operuar në kushtet e shikimit të kufizuar dhe me armatim të ndërveprueshëm, për të siguruar fuqinë e nevojitur të zjarrit. Ato do të mund të kryejnë operacione të pavarura për nivele të vogla angazhimesh (deri në togë ose kompani për të mbajtur terrenin dhe, sipas detyrës, për ta përballuar, izoluar neutralizuar ose asgjësuar kundërshtarin), operacione në prapavijë, operacione në terrene malore, pyjore, zona të thepisura dhe në zona urbane, operacione joluftarake, si dhe të operojnë në bashkëpunim me forcat Aleate.

Secili batalion do të pajiset me mjete ndërlidhjeje të ndërveprueshme, që përputhen me STANAG-ët e NATO-s, do të zotërojë kapacitete mjekësore Rol 1 dhe asete organike për t'i mundësuar transportimin e një kompanie të përforcuar këmbësorie, të aftë për të mbështetur operacione të pavarura për 5 ditë. Batalionet e këmbësisë do të jenë kapacitete efektive me lëvizshmëri e gatishmëri të lartë, dislokueshmëri të shpejtë, fleksible për t'u përshtatur me ndryshimet e situatës dhe të afta për të vepruar me mëvetësi, sidomos brenda vendit apo në terrene të përafërta me të. Gjithashtu batalionet janë kapacitete të gatshme për të vepruar në operacione joluftarake.

Batalioni i dytë i këmbësisë është prioritet i parë i FA dhe do të shërbejë si element qendror i grup-batalionit. Grup-batalioni do të jetë kapaciteti esencial i FT në gjendje të kryejë misione të të gjithë spektrit,

nga ofrimi i ndihmës në rast të emergjencave dhe katastrofave humanitare, pjesëmarrje në operacionet e kërkim-shpëtimit, operacionet në mbrojtje të popullsisë civile, mbështetjen e autoriteteve civile e deri te ndërhyrja në konfliktet e armatosura, brenda dhe jashtë vendit. Për operacionet jashtë vendit, grup-batalioni do të jetë i aftë për t'u dislokuar me shpejtësi (brenda 90 ditëve) për një periudhë deri në 6 muaj (pa rotacion) dhe për të vepruar në mënyrë autonome me mëvetësi deri në 10 ditë (ose deri në 30 ditë në rast se rifurnizohet).

Për të krijuar këtë kapacitet nevojiten burime të konsiderueshme financiare për sigurimin e pajisjeve kritike dhe mbështetëse, armatimin, personelin dhe trajnimin e stërvitjen e mjaftueshme për të përmbushur kriteret e gatishmërisë, me qëllim që të gjithë elementët e grup-batalionit të dislokohen me shpejtësi dhe të operojnë në zonat e operacionit. Për arritjen e efektivitetit (disponueshmërinë, dislokueshmërinë, gatishmërinë, fleksibilitetin, kohezionin, mëvetësinë, mbijetesën dhe mbështetjen mjekësore), grup-batalioni do të ketë edhe kapacitetet e mbështetjes së luftimit dhe elementet e mbështetjes me shërbime të luftimit, si dhe asete ose zgjidhje kontraktuale për transportin strategjik, mbështetjen dhe ridislokimin, e cila kërkon planifikim në detaje, burime të konsiderueshme, kohezion dhe ndërveprim.

Batalioni i Forcave Speciale (BFS) është organizuar për të kryer operacione speciale brenda dhe jashtë vendit, me qëllim arritjen e objektivave operacionale dhe strategjike të Forcave të Armatosura të RSH. Ky batalion zotëron armë, pajisje të lehta dhe ndërlidhje të ndërveprueshme me NATO-n.

BFS kryejnë një spektër të gjerë detyrash në mënyrë të pavarur, të drejtpërdrejtë dhe të shkallëzuar, të tilla si operacione antiterroriste, operacione jokonvencionale, kundër trafikut të armëve (apo kundër përhapjes së ADM-ve), për shpëtim pengjesh apo edhe operacione për kapjen e objektivave kyç të armikut, si dhe detyra të tjera me rëndësi strategjike.

Batalioni Komando është i organizuar për të kryer operacione luftarake dhe joluftarake, në kushte të veçanta, brenda dhe jashtë vendit, në kohë paqeje, krize e lufte, ditën, natën dhe në një mjedis me prezencë të ADM, si dhe përfshin kapacitete për të kryer misione nën kushte ekstreme të motit dhe terrenit.

**Batalioni i Mbështetjes së Luftimit.** Është një strukturë e re e mbështetjes së luftimit të FT, i cili përfshin kapacitete që rritin fuqinë e zjarrit dhe kapacitete shkatërruese në fushën e luftimit për të arritur efektet, të cilat asnjë kapacitet nuk mund t'i arrijë më vetë. Kapacitetet që do të ofrojë Batalioni i Mbështetjes së Luftimit përbëhet nga kapacitetet e zjarrit indirekt për batalionet operacionale, xhenio luftimi, si dhe zbulim e detektim nga ADM dhe personel e pajisje të kufizuara me kapacitete dekontaminimi. Elementë të veçantë të këtij batalioni do të plotësojnë kapacitetet e kërkuara nga grup-batalioni i këmbësorisë.

### 5.1.2 Planet e zhvillimit të kapaciteteve të FT

FT aktualisht ka kapacitete operacionale të kufizuara, të cilat do t'i zhvillojë dhe do t'i përmirësojë. Pavarësisht nga nevojat e konsiderueshme, krijimi dhe zhvillimi i aftësive të plota operacionale do të jetë një proces i gjatë, gradual, i kushtëzuar dhe i sinkronizuar nga shumë faktorë. Faktori financiar është vendimtar në zhvillimin e forcës. Përgjithësisht mundësitë financiare do të përcaktojnë ritmin, përshkallëzimin, prioritetin dhe kohëzgjatjen e zhvillimit të forcës. Bazuar në konceptin e mësipërm të zhvillimit gradual, me prioritet dhe në mënyrë të sinkronizuar, në vijë të përgjithshme koncepti i planifikimit afatgjatë të zhvillimit të FT do të konkretizohet sipas fazave të mëposhtme:

#### Në periudhën 2016–2018

Do të zhvillohen dhe do të përmirësohen kapacitetet operacionale, të cilat do të mundësojnë zhvillimin e operacioneve luftarake në nivel kompanie, kryesisht për situata rreziku ose kërcënim të terrorist, operacione humanitare, të vëzhgimit dhe monitorimit të hapësirës tokësore e ajrore të vendit, të mbështetjes së strukturave të tjera të sigurisë kombëtare për nevojat të rendit kushtetues, me prioritet njësitë e deklaruara në përbërje të Forcës së Reagimit të Shpejtë të Aleancës. Konkretisht, strukturat që planifikohen të zhvillohen me prioritet, në këtë periudhë do të jenë:

- Batalioni II i Këmbësorisë;
- Batalioni i Forcave Speciale;
- Një Togë Zbulimi për Sigurimin e Kapaciteteve ISTAR (Kompania e Zbulimit, batalioni “Komando”);
- Një Togë për Mbështetjen me Zjarr Indirekt (Batalioni i Mbështetjes së Luftimit);
- Një togë speciale për MADM (Batalioni i Mbështetjes së Luftimit).

Me qëllim zhvillimin e strukturave të mësipërme, nevojitet përsosja e kapaciteteve si vijon:

- Kompletimi me armatim të lehtë të këmbësorisë, duke filluar nga pajisja e batalionit II të Këmbësorisë, Batalionit të Forcave Speciale, Batalionit Komando, elementët mbështetës të grup-batalionit dhe kompletimi i gjithë FT së bashku me sasinë e municionit përkatës;

- Pajisja me pajime individuale të ushtarit;
- Sistemi i komandim, kontroll, komunikim, kompjuterizim, informimit (C4I) të FT;
- Kontributi me njësi taktike në përbërje të NRF, të pajisur me:
- Armatim të lehtë të këmbësorisë të ndërveprueshëm;
- Pajisjet individuale të luftimit;
- Sisteme komunikimi të ndërveprueshme;
- Pajisje dhe mjete individuale të shikimit natën;
- Pajime individuale për të operuar në kushte ekstreme moti dhe terreni (mot të nxehtë dhe të thatë, mot ekstrem i ftohtë arktik).

*Rezultate të pritshme do të jenë si vijon:*

- Një batalion këmbësorie, i cili do të jetë i gatshëm për t'u dislokuar në operacione luftarake dhe angazhimet e NATO-s (me intensitet jo të lartë), për një periudhë deri në 6 muaj, me mbështetje me shërbime të luftimit nga njësi të ofruara nga NATO;

- Krijimi i grupit/Njesisë së Detyrës për Operacionet Speciale (SOTG/SOTU), sipas standardeve dhe kërkesave të NATO-s.

### **Në periudhën 2019–2021**

Objektiv do të jetë modernizimi i sistemeve dhe pajisjeve për përmirësimin e kapaciteteve të nevojshme për përmbushjen e misionit dhe detyrave. Modernizimi do të bazohet në kërkesat dhe detyrimet, sipas paketës së objektivave të kapaciteteve. Kjo nënkupton vazhdimin e zhvillimit të kapaciteteve operacionale të grup-batalionit dhe Grupit/Njesisë së Operacioneve Speciale të Detyrës.

Në periudhën afatmesme, njësitë dhe strukturat prioritare do të zhvillojnë kapacitetet e mëposhtme:

Mjete dhe pajisje të vrojtimit-zbulimit taktik dhe përcaktimit të objektivave, i planifikuar të realizohet (projekti vijon nga periudha afatshkurtër);

- Mjete dhe pajisje bazë dhe speciale xheniere, faza e parë (pajisjet kritike për mision);
- Armatimi, teknika dhe pajisje individuale speciale;
- Komplete personale për mbrojtjen e forcave (Force Protection).

*Rezultate të pritshme do të jenë si vijon:*

- Sigurimi i sistemeve, armatimit, teknikës, pajisjeve të avancuara për të gjitha strukturat e parashikuara për angazhim në operacionet e NATO-s, BE-së, OKB-së;

- Grup-batalioni i këmbësorisë i gatshëm për t'u dislokuar në operacione luftarake me intensitet të lartë dhe angazhimet e NATO-s për një periudhë deri 6 muaj pa rotacion;

Gjithashtu, në këtë periudhë do të zhvillohen edhe një sërë kapacitetesh të mbështetjes së luftimit në shërbim të grup batalionit, të tilla si:

- Kapacitete për zjarr indirekt (artileri/mortaja);
- Kapacitete për mbrojtjen kundërajrore të bazuara në tokë (GBAD);
- Kapacitete bazë xheniere për lëvizshmërinë dhe kundërlëvizshmërinë;
- Kapacitete të ISTAR dhe zbulimit me njerëz (HUMINT);
- Mjete/pajisje xheniere dhe speciale.

### **Në periudhën 2022–2025**

Objektiv do të jetë zhvillimi dhe konsolidimi cilësor i të gjitha strukturave ushtarake të FT, me kapacitete operacionale të plota që t'i përgjigjen të gjitha detyrave të misionit.

- Përmirësimi i kapaciteteve me pajisje dhe trajnim për kryerjen e operacioneve në zona urbane për të goditur objektiva të fortifikuar dhe strehime, futja në përdorim e mjeteve tokësore luftarake pa drejtues (Unmanned Air Vehicles, UAV), (Unmanned Ground Vehicles, UGV);

- Mjete/pajisje bazë dhe speciale xheniere, faza e dytë;
- Mjete të blinduara;

- Kapacitete të kontrollit të mbështetjes ajrore (Tactical Air Control Party, TACP);

- Rritja e kapaciteteve për zjarr indirekt me sisteme precize më të fuqishme artilerie me larghedhje dhe lidhja e sistemit të zjarrit me pikturën e përgjithshme operacionale dhe sistemin ISTAR.

**5.2 Forca Detare (FD)** përbëhet nga Komanda dhe Shtabi, Kompania e Mbështetjes së Shtabit, Qendra Stërvitore, Flotilja Detare, Qendra e Vëzhgimit Detar, Shërbimi Hidrografik dhe Qendra Kombëtare e Zhytjes.

*FD përgatitim dhe vënë në dispozicion kapacitete për ruajtjen e tërësisë territoriale detare dhe të drejtave sovrane të Republikës së Shqipërisë, në bashkëveprim me strukturat e tjera të FA, zbatimin e ligjit kombëtar dhe ndërkombëtar në det, në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore me interesa në hapësirën detare.*

FD realizon detyra për ruajtjen e tërësisë territoriale detare të RSH-së, në përmbushje të misionit kushtetues, zbaton detyrat e bazuara në ligj për Rojën Bregdetare dhe Kërkim-Shpëtimin në det, si dhe bashkëvepron me strukturat e tjera kombëtare për zbatimin e legjislacionit kombëtar e ndërkombëtar në hapësirën detare. Struktura organizative e FD është një organizim integral pa ndonjë vijë ndarëse midis dy strukturave, sipas konceptit “një forcë dy misione”.

Përdorimi operacional i njësive të FD për kryerjen e detyrave të Rojës Bregdetare është përgjegjësi e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare.

Për plotësimin optimal të misionit të FD, mjetet lundruese organizohen në kuadër të një Flotiljeje Detare. Përdorimi i njësive të FD bëhet nga bazat operacionale detare, të cilat janë të shpërndara përgjatë gjithë bregdetit të Shqipërisë. Forca Detare siguron prani operacionale, kryesisht për t’u dhënë asistencë dhe ndihmë përdoruesve të ujërave të brendshme territoriale.

Për plotësimin e misionit FD zbaton këto detyra:

- Kryen patrullim për garantimin e sigurisë në hapësirën kombëtare detare;
- Organizon dhe drejton operacionet e kërkim-shpëtimit në hapësirën detare të RSH-së;
- Mbështet strukturat qendrore dhe vendore në emergjenca civile;
- Garanton sigurinë hidro-lundrimore në bregdetin dhe hapësirën detare të RSH-së;
- Monitoron zbatimin e legjislacionit shqiptar dhe normat e së drejtës ndërkombëtare, të pranura nga vendi ynë në hapësirën detare të RSH-së;

Forca Detare mbron sovranitetin e vendit nëpërmjet prezencës në det dhe kryerjes së operacioneve të sigurisë detare, të cilat i kryen më vete, në bashkëpunim me strukturat e FA, aleatët dhe me institucionet e zbatimit të ligjit që kanë interesa në det.

Nëpërmjet zbatimit të detyrave të Rojës Bregdetare, FD është autoriteti kryesor për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në det. Zbatimi i ligjit në det kërkon parandalimin dhe reagimin ndaj veprimtarive që lidhen me shfrytëzimin e paligjshëm të pasurive detare e nëndetare, trafikun e paligjshëm të mallrave dhe mjeteve, regjimin dhe rregullat lundrimore e të peshkimit, veprimtarinë kriminale e terroriste që kryhet në det dhe nëpërmjet detit, si dhe mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja.

Kërkim-shpëtimi në det është një tjetër detyrë, për të cilën FD është autoriteti kryesor për realizimin e këtyre operacioneve. FD zotëron kapacitetet e nevojshme për planëzimin, organizimin dhe zhvillimin e operacioneve të bashkuara (me shërbimet e tjera) dhe të përbashkëta (me shtete të tjera) për kërkim-shpëtimin dhe dhënien e ndihmës në det, në bashkëveprim me strukturat shtetërore dhe ndërkombëtare që veprojnë në hapësirën e tyre të përgjegjësisë.

Forca Detare do të vijojë zhvillimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të reagimit dhe monitorimit të hapësirës detare nëpërmjet modernizimit me anije të reja patrulluese bregdetare e detare, modernizimit dhe përmirësimit të infrastrukturës dhe komponentëve të SIVHD-së, prokurimit të armatimit të anijeve, rritjes së operacionalitetit të grupeve të bordingut dhe përmirësimit të infrastrukturës së bazave detare.

### 5.2.1 Kapacitetet e Forcës Detare

Kapacitete për operacionet luftarake të Forcës Detare. Ruajtja e tërësisë territoriale detare është një interes jetik për Republikën e Shqipërisë, si dhe për çdo shtet me dalje në det. FD nuk disponon anije të mirëfillta luftarake, por në planin afatgjatë do të modernizohet me anije patrulluese 55-60 metra, të cilat do të kenë kapacitete të kryejnë detyra luftarake në distanca të largëta nga bregdeti, në kushte të vështira të detit dhe motit. Këto anije do të kenë të instaluar kapacitete të luftimit, të cilat përfshijnë mbrojtjen kundërajrore, detare, bregdetare, të njohjes së situatës detare etj. Krahas detyrave luftarake për mbrojtjen e sovranitetit në hapësirën detare, ato do të përdoren edhe në mbështetje të operacioneve të ndalimit detar, zbatimit të ligjshmërisë detare, kundër terrorizmit, të kërkim-shpëtimit, operacione në det, të kontrollit të aktivitetit të peshkimit dhe monitorimit të hapësirës detare nga ndotja.

Kapacitetet për Rojën Bregdetare dhe Kërkim-Shpëtimin. Spektri i misionit të Rojës Bregdetare është i gjerë si në autoritet, edhe në hapësirë. Ai shtrihet nga vija bregdetare deri në kufijtë e detit territorial për ushtrimin e sovranitetit kombëtar, si dhe në hapësirën detare ku Shqipëria ushtron të drejtat e saj sovraane (zonën ekonomike ekskluzive).

Modernizimi do të eliminojë mangësitë në kapacitetet e FD (për Rojën Bregdetare) që kanë mbushur ciklin jetësor, me anije të vogla patrulluese me përmasa 25-30 metra. Këto lloj anijesh do të përdoren për operacione të patrullimit detar, të ndalimit detar, zbatimit të ligjshmërisë detare, kundër terrorizmit, të kërkim-shpëtimit, operacione në det, të kontrollit të aktivitetit të peshkimit dhe monitorimit të hapësirës detare nga ndotja, por edhe për detyra luftarake.

Kapacitete të mbështetjes. FD, në përmbushje të detyrave të Shërbimit Hidrografik Shqiptar dhe Qendrës së

Zhytjeve, do të modernizohet me një anije shumëfunksionëse hidrografike dhe polumbare. Kjo anije do të përshtatet dhe do të zotërojë kapacitete për transportin, uljen dhe ngritjen e ngarkesave, mbajtjen e sistemeve polumbare, kryerjen e matjeve detare dhe përpunimin e informacionit hidrografik. Për dhënien e ndihmës në rast fatkeqësie në det, FD do të modernizohet me një rimorkiator të mesëm detar, i cili do të ketë kapacitetet e nevojshme për rimorkimin dhe dhënien e asistencës për anijet e tjera, të cilat kanë pësuar avari (përmbetje ose zjarr).

Misionin dhe detyrat e saj, FD i përmbush nëpërmjet kapaciteteve të Flotiljes Detare, Sistemit të Vëzhgimit të Hapësirës Detare, Shërbimit Hidrografik, Qendrës së Zhytjeve, si dhe Qendrës së Stërvitjes së FD.

Flotilja Detare përbëhet nga bazat detare dhe anijet, të cilat janë kapacitetet kryesore operacionale për realizimin e operacioneve, në përmbushje të misionit dhe detyrave të FD. Flotilja Detare përmbush misionin dhe detyrat duke përdorur me efektivitet kapacitetet dhe burimet, nëpërmjet prezencës së përhershme në hapësirën detare dhe gatishmërisë për t'iu përgjigjur shpejt, ku dhe kur e kërkon situata. Ajo përgjigjet edhe për trajnimin dhe stërvitjen e ekuipazheve të anijeve dhe grupeve të bordingut, si dhe luan rolin e “force provider” në operacionet e drejtuara nga struktura të tjera shtetërore.

Bazat detare mbështetin operacionet detare dhe mundësojnë prezencën e anijeve në të gjithë hapësirën kombëtare detare, mbështetin mjetet detare me infrastrukturën e nevojshme, stërvitjen dhe sigurojnë kushtet e punës dhe jetesës për personelin. Investimet në infrastrukturën e bazave detare do të përmirësojnë kushtet e sigurisë, mbështetjen e anijeve me shërbimet e nevojshme dhe stërvitjen e personelit.

Anijet janë kapacitetet kryesore për përmbushjen e misionit dhe zbatimin e detyrave të Flotiljes Detare, në hapësirën detare të RSH-së. Zona e përgjegjësisë së Flotiljes Detare, në të cilën anijet zbatojnë detyra operacionale, shtrihet në Detin Territorial, Zonën e Afërt Kufitare dhe Zonën Ekskluzive Ekonomike. FD do të modernizohet me anije të reja, në përmbushje të detyrave luftarake, ato të Rojës Bregdetare dhe të mbështetjes njëkohësisht me daljen nga shërbimi i anijeve, të cilat kanë plotësuar ciklin jetësor.

Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD) realizon vëzhgimin e vazhdueshëm të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë me anë të radarëve të instaluar përgjatë bregdetit. Me informacionin që ky sistem siguron, FD kontribuon:

- në funksionimin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare;
- në operacionin “ACTIVE ENDEAVOUR”;
- në njohjen e situatës detare në rrjetin rajonal dhe transrajonal “V-RTMC” dhe “T-RMN”.

Për të garantuar operacionalitetin e plotë të sistemit të SIVHD, ajo do të përmirësohet më tej nëpërmjet përditësimit dhe modernizimit të sistemeve të saj.

Shërbimi Hidrografik Shqiptar siguron kushtet për lundrim të sigurt në hapësirën territoriale detare nëpërmjet matjeve detare, mirëmbajtjes së sistemit të faro-fenerëve të lundrimit, bovave dhe sinjalistikës detare. Shërbimi Hidrografik kryen studime të karakterit hidrografik dhe hidrologjik të bregdetit shqiptar, relievit dhe fundit të detit, si dhe bashkëpunon me Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake për përgatitjen e hartave detare, udhëzuesve të lundrimit dhe manualit të faro-fenerëve. Modernizimi i mëtejshëm i saj përfshin pajisjen me kapacitete për transport, riparim faro-fenerësh, matje detare dhe kapacitete për përgatitjen e hartave detare. Modernizimi i Shërbimit Hidrografik do të mbështetet edhe nga marrëveshjet në kuadër të bashkëpunimit bilateral.

Qendra e Zhytjeve ka kapacitete për realizimin e operacioneve nënujore, në mbështetje të misionit dhe detyrave të FD. Qendra e Zhytjeve do të modernizohet me ambiente të reja për punën dhe trajnimin e personelit, pajisje speciale për operacionet e zhytjes, kapacitete për kryerjen e operacioneve EOD.

### **5.2.2 Planet e zhvillimit të kapaciteteve të Forcës Detare**

Në mënyrë të përmbledhur FD do të zhvillojë kapacitetet e saj sipas fazave të mëposhtme:

#### **Në periudhën 2016-2018**

Përmirësimi i SIVHD-së dhe i kapaciteteve të zbulimit të anijeve në det, si dhe integrimi i tyre në një qendër të vetme të përpunimit të informacionit do të jetë objektiv kryesor i kësaj periudhe. Në këtë periudhë është e domosdoshme kryerja e investimeve në infrastrukturën aktuale, me qëllim rritjen e sigurisë dhe operacionalitetin e bazave detare. Projektet kryesore që do të zbatohen do të jenë:

- Sistemi dixhital i identifikimit të anijeve luftarake (W-AIS);
- Pajisja e SIVHD me kamera optike/infrared dhe përditësimi i sistemit;
- Kompletimi i grupit të bordimit me armatim, pajisje dhe komplete individuale;
- Investime infrastrukturore në bazën detare të Kepit të Palit dhe Qendrën Stërvitore;

- Rinovim i kullave të fenerëve detarë.

Rezultate të pritshme do të jenë si vijon:

- Do të përmirësohen ndjeshëm kapacitetet e FD për monitorimin dhe njohjen e situatës në hapësirën detare të RSH-së.

- Do të rritet operacionaliteti i bazës detare të Kepit të Palit.

- Do të sigurohet vijueshmëria e shërbimit të sinjalistikës detare për të garantuar lundrim të sigurt në hapësirën detare të RSH-së.

**Në periudhën 2019-2021**

Sigurimi i sistemeve automatike të armatimit për anijet e klasit “Iliria”, rritja e kapaciteteve për kryerjen e operacioneve të ndalimit detar, si dhe zhvillimi i kapaciteteve për operacione EOD nënujore do të konsolidojnë më tej aftësitë e FD për zbatimin e misionit dhe detyrave. Edhe gjatë kësaj periudhe është domosdoshmëri që investimet në infrastrukturë të vijnë, me qëllim përmirësimin e kushteve për punë, stërvitje dhe rritjen e sigurisë së përdorimit të anijeve në bazat detare. Projektet kryesore që do të zbatohen gjatë kësaj periudhe do të jenë:

-Sigurimi i një anije polumbare/hidrografike;

-Pajisja e anijeve të klasit “ILIRIA” me sistem automatik armatimi 20 mm;

-Pajisja e SIVHD me sistem autonom për energji elektrike, zgjerimi i kapacitetit transmetues dhe ndërtimi i sistemit rezervë “Back Up”;

-Ndërtimi i Qendrës së Zhytjeve, Pashaliman;

-Sigurimi i pajisjeve speciale polumbare EOD për Qendrën e Zhytjeve;

-Rivitalizimi i infrastrukturës së Vendbazimit Shëngjin.

Rezultate të pritshme në do të jenë si vijon:

- Do të rriten kapacitetet e FD për kryerjen e operacioneve të ndalimit detar dhe siguria e personelit gjatë kryerjes së operacioneve.

- Do të krijohen kapacitetet e duhura për stërvitjen dhe sigurinë e personelit zhytës, si dhe kryerjen e operacioneve EOD nënujore.

**Në periudhën afatgjatë 2022-2025**

Gjatë kësaj periudhe, është domosdoshmëri kompletimi i FD me anije të reja, me synim rritjen e kapaciteteve për kryerjen e detyrave në hapësirën detare të RSH-së. Rritja e kapaciteteve do të mundësojnë realizimin e gjithë spektrit të detyrave të FD edhe në kushtet më të vështira të motit dhe të detit. Anijet, të cilat kanë plotësuar ciklin jetësor, do të zëvendësohen gradualisht, duke shmangur krijimin e mangësive në këto kapacitete.

- Projektet kryesore që do të fillojnë përshijnë:

- Sigurimin e gjashtë anijeve të vogla patrulluese 25-30 m;

- Sigurimin e dy anijeve të mesme patrulluese 55-60 m;

- Sigurimin e një rimorkiatori të mesëm.

Rezultate të pritshme do të jenë si vijon:

- Do të rriten kapacitetet e FD për kryerjen e operacioneve detare, si dhe do të sigurohet modernizimi me anije, të cilat do të kenë kapacitete e nevojshme për operacione në kushte të vështira të detit.

**5.3 Forca Ajrore (FAj)** përbëhet nga Komanda dhe Shtabi, Kompania e Mbështetjes së Shtabit, Qendra e Kontroll-Raportimit, Qendra Stërvitore, Baza Ajrore Kuçovë, Baza Ajrore Farkë, Shërbimi Meteorologjik Ushtarak.

*FAj siguron kapacitetet e nevojshme për mbrojtjen e sovranitetit të hapësirës ajrore të RSH, në bashkëveprim me strukturat e NATO-s, mbështetjen ajrore taktike për operacionet luftarake e joluftarake të FA-së dhe NATO-s, sigurimin e Shërbimit Meteorologjik, Shërbimit SAR ajror dhe transport të personaliteteve shtetërore”.*

Për plotësimin e misionit FAj zbaton këto detyra:

- Monitoron, kontrollon dhe paralajmëron në kohë mbi kërcënimin ajror të hapësirës ajrore të RSH-së, në bashkëpunim me strukturat e FA-së dhe të NATO-s;

- Siguron komandim-kontrollin e reparteve dhe nënreparteve të varësisë;

- Mbështet me shërbim meteorologjik Forcat e Armatosura dhe institucionet e tjera shtetërore;

- Kundërvepron, në bashkëveprim me NATO-n, ndaj shkeljeve të hapësirës ajrore;

- Siguron, në bashkëveprim me NATO-n, objektet e rëndësishme të veçantë me mbulim ajror, bazuar në implementimin e sistemit NATINAMDS;

-Kryen operacione kërkim-shpëtimi dhe humanitare në ndihmë të popullsisë civile;

-Planifikon dhe kryen trajnimin e stërvitjen e nevojshme të personelit të FAj.

FAj mbron sovranitetin e hapësirës ajrore të vendit, duke bashkëpunuar me agjencitë e koordinimit të hapësirës ajrore të NATO-s dhe Albkontroll-in për vëzhgimin ajror dhe patrullimin e hapësirës ajrore të RSH-së nga aleatët.

Programi i modernizimit të FAj do të rritë kapacitetet operacionale për monitorimin, komunikimin e shpejtë, shkëmbimin e informacionit mbi situatën ajrore, rritjen e ndërveprimit, kundërveprimin e menjëhershëm, në rast të kërcënimit ajror të trupave dhe objekteve të rëndësishme, ndihmën në emergjenca civile dhe mbështetjen e operacioneve të drejtuara nga NATO.

Kapacitetet kryesore të FAj janë Qendra e Kontroll-Raportimit (QKR), bazat ajrore Farkë dhe Kuçovë, Shërbimi Meteorologjik dhe Qendra Stërvitore e F. Ajrore.

### **5.3.1 Kapacitetet e Forcës Ajrore**

Qendra e Kontroll-Raportimit (QKR) do të zhvillojë dhe do të përmirësojë kapacitete për monitorimin dhe kontrollin e hapësirës ajrore të RSH, raportimin dhe përpunimin e të dhënave të shenjave ajrore në zonën e përgjegjësisë të elementeve të vëzhgimit ajror, drejtimin e mjeteve të fluturimit të forcës ajrore në hapësirën ajrore të RSH-së, si dhe stërvitjen, përgatitjen dhe mbajtjen në gatishmëri të forcave dhe mjeteve në dispozicion.

Instalimi i sistemit MASE (*Multi Aegis Site Emulator*) dhe ndërveprimi me Albcontrol për marrjen e pamjes ajrore ka rritur ndjeshëm operacionalitetin e kësaj qendre.

Kompletimi me kapacitete të vëzhgimit (radar 3-D) dhe instalimi i ASBE (*Air System Base Element*) do të mundësojë prodhimin e pamjes ajrore dhe ndërveprimin me strukturat e NATO-s. Përmirësimi i kapaciteteve ekzistuese do të realizohet duke finalizuar projektin e modernizimit të flotës së helikopterëve me dy mjete ajrore SAR, si dhe duke kompletuar helikopterët që do të vihen në dispozicion të Aleancës me armatim vetëmbrojtës, duke trajnuar pilotët për versionet SAR, Casevac, IFR dhe përdorimin taktik në operacion. Trajnimi i efektivave fluturues, duke arritur gradualisht normat e Aleancës për orët e fluturimit, do të mundësojë arritjen e nivelit të gatishmërisë operacionale.

Baza Ajrore Farkë ka kapacitete në gatishmëri për përmbushjen e detyrave luftarake dhe atyre stërvitore, mbështet FT me transport trupash dhe materialesh, kryen operacione humanitare në ndihmë të popullsisë, operacione të kërkim-shpëtimit dhe mbështet operacionet e zbulimit ajror dhe rikonicionit. Kjo bazë realizon shërbimet e mirëmbajtjes teknike deri në nivel të dytë në kohë dhe sipas kërkesave teknike të përcaktuara, si për mjetet ajrore, ashtu dhe për mjetet tokësore që ka në përdorim.

Ristrukturimi i Bazës Ajrore Farkë, si dhe përfundimi i paketës së modernizimit me helikopterë të rinj COUGAR dhe EC 145 rrit gradualisht nivelin e operacionalitetit të kësaj baze. Shfrytëzimi në ajër i sistemeve moderne të komunikimit, navigimit, interceptimit dhe alertit të helikopterëve, në bashkëpunim me sistemet moderne në tokë të AAC (Autoriteti i Aviacionit Civil), janë prioritet të stërvitjes ajrore që synojnë rritjen e sigurisë së fluturimit në kushte të vështira meteorologjike ditën dhe natën.

Mbajtja në gatishmëri e helikopterëve AB-205 dhe BO-105, si dhe rifutja në TOP e helikopterit AB-206 e A 109C synon uljen e kostos së fluturimit për trajnim, riaktivizimin e Qendrës së Stërvitjes së FAj, si dhe mbajtjen në gatishmëri të efektivave fluturues. Prurjet e reja me personel të kualifikuar teorikisht në shkollat e aviacionit në Turqi dhe Itali do t'i nënshtrohen përgatitjes fluturuese me helikopterë trajnues AB-206 dhe BO-105 në Shqipëri.

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak funksionon sipas standardeve ndërkombëtare, duke shfrytëzuar hartat e modeleve matematikore për parashikimin e motit dhe siguron informacion të nevojshëm mbi konditat meteorologjike në interes të operacioneve të FA, të institucioneve të tjera dhe në interes të komunitetit. Rrjeti i vrojtimit të shërbimit meteorologjik përbëhet nga 10 stacione. Stacionet meteorologjike Vlorë, Gjirokastrë, Durrës, Kukës e Farkë janë të kompletuara me kapacitete të reja, ku të dhënat lexohen në mënyrë automatike dhe memorizohen. Shërbimi Meteorologjik Ushtarak transmeton rregullisht të dhënat për situatën meteorologjike në rajon e më gjerë.

Për vitet në vazhdim parashikohet ndërtimi i qendrave sinoptike në Tropojë, Elbasan dhe Sarandë.

Qendra Stërvitore e Forcës Ajrore është strukturë e re, e cila ka nevojë për riorganizim, mbështetje konceptuale e logjistike, si dhe trajnim të personelit instruktor të saj për të qenë efektive. Kjo strukturë do të fuqizohet në këto drejtime për të qenë e aftë të realizojë trajnimet dhe kualifikimet që nuk mund të sigurohen prej vendeve aleate apo do të ketë kosto shumë të lartë dhe rentabilitet të ulët.

Filozofia e ekzistencës së kësaj strukture do të jetë ruajtja dhe përditësimi i njohurive të përfituara nga kualifikimet jashtë vendit. Përveç certifikimeve, që janë autoritet i strukturave të posaçme të kompanive të ndryshme private dhe ICAO-s, kjo strukturë gradualisht duhet të përmirësohet për certifikim personeli,

sidomos për kurset funksionale.

Baza Ajrore Kuçovë do të ngelet në rezervë dhe në pritje të vendimit për zhvillimin e masterplanit të saj dhe përdorimin si kapacitet në kuadër të mbështetjes si vend pritës.

### **5.3.2 Planet e zhvillimit të kapaciteteve të Forcës Ajrore**

Zhvillimi i kapaciteteve të Forcës Ajrore planifikohet të realizohet sipas fazave të mëposhtme:

#### **Në periudhën 2016–2018**

Do të zhvillohen dhe do të përmirësohen kapacitetet dhe aftësitë operacionale, të cilat do të mundësojnë zhvillimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit, të vëzhgimit dhe monitorimit të hapësirës ajrore të vendit, të mbështetjes së strukturave të tjera me transport trupash dhe materialeve dhe në kryerjen e operacioneve humanitare në ndihmë të popullsisë. Konkretisht, strukturat që planifikohen të zhvillohen në këtë periudhë do të jenë:

- Baza Ajrore Farkë;
- Baza Ajrore Kuçovë;
- Qendra e Kontroll-Raportimit;
- Garnizoni Rinas.

Me qëllim zhvillimin e strukturave të mësipërme, është e domosdoshme përsosja e kapaciteteve si vijon:

- Kompletimi me 2 helikopterë EC 145;
- Jetësim i projektit për vëzhgimin e hapësirës ajrore;
- Kompletimi i helikopterëve të rinj me pajisje mjekësore (CASEVAC);
- Kompletimi me pajisje individuale luftarake për pilotët e FAj.

#### Rezultate të pritshme do të jenë si vijon:

- Rritja e kapaciteteve të shërbimit të kërkim-shpëtimit (SAR);
- Integrimin progresiv, sipas standardeve të kërkuara në NATINAMDS;
- Rritje e cilësisë së shkëmbimit të informacionit me entet e tjera kombëtare dhe NATO-n.

#### **Në periudhën 2019–2021**

Objektiv do të jetë zhvillimi dhe konsolidimi i kapaciteteve operacionale, të cilat do të mundësojnë vëzhgimin dhe monitorimin e hapësirës ajrore, rritjen e operacionalitetit të përdorimit dhe përsosja e kapaciteteve operacionale të përdorimit të helikopterëve në fushëbetejë dhe në kushte të kufizuara të shikimit, duke i pajisur me sisteme të vetëmbrojtjes dhe pajisje për shikim natën.

Për realizimin e detyrimeve të kësaj periudhe është i domosdoshëm zhvillimi i kapaciteteve dhe i programeve të modernizimit si më poshtë:

- Sistemi i vetëmbrojtjes së helikopterëve (Kompletimi i helikopterëve me armatim vetëmbrojtës);
- Radar 3-D stacionar, primar–sekondar;
- Stacione meteorologjie;
- Pajisje për shikim natën;
- Rikonstrukcion QKR;
- Sigurimi i kapaciteteve të komunikimit Tokë-Ajër-Tokë (G-A-G);
- Pajisjet e sistemit të sigurisë, Rinas.

#### Rezultate të pritshme do të jenë si vijon:

- Sigurimi i sistemeve të vetëmbrojtjes së helikopterëve, duke rritur sigurinë në ajër për plotësimin e misionit në fushëbetejë;
- Rritjen e operacionalitetit të përdorimit të helikopterëve në kushte të kufizuara të shikimit ditën, natën dhe kushte të vështira të motit;
- Zbatimi i projektit për infrastrukturën mbështetëse të instalimit të radarit;
- Zhvillimi i sistemeve të navigimit dhe komunikimit në tokë;
- Rritja e sigurisë në ajër për plotësimin e misioneve në fushëbetejë;
- Përmirësimi i sistemeve të komunikimit tokë-ajër-tokë.

#### **Në periudhën 2022–2025**

Është i domosdoshëm zhvillimi i kapaciteteve reaguese me kapacitete/aftësi operacionale që t'u përgjigjen të gjitha detyrave dhe misionit të Forcës Ajrore.

- Sisteme të mbrojtjes ajrore, si dhe integrimi i tyre me sistemin “NATINAMDS”;
- Radar 3-D, stacionar, primar–sekondar;
- Kapacitete kombëtare për sigurimin e sovranitetit të hapësirës ajrore të RSH-së.

#### Rezultate të pritshme do të jenë si vijon:

- Krijimi i kapaciteteve kombëtare të reagimit ndaj objektivave fluturues (të bazuara në tokë);

- Zhvillimi i kapaciteteve kombëtare për vëzhgimin e hapësirës ajrore.

**5.4 Komanda Mbështetëse (KM)** përbëhet nga Komanda dhe Shtabi, Kompania e Mbështetjes së Shtabit, Batalioni i Furnizimit, Batalioni i Transportit, Batalioni i Municioneve (i përkohshëm), Batalioni i Xhenios, Batalioni i Mbështetjes Rajonale, Qendra e Riparimit dhe Mirëmbajtjes së Teknikës së Forcave të Armatosura, Spitali Ushtarak i FA dhe Qendra Stërvitore.

*KM siguron mbështetjen e strukturave dhe operacioneve të FA me shërbime mbështetëse të luftimit për kryerjen e operacioneve luftarake dhe joluftarake, si dhe mbështetjen e popullsisë në rast emergjencash civile.*

Për plotësimin e misionit, KM zbaton këto detyra kryesore:

- Mbështet operacionet dhe veprimtarinë e FA brenda dhe jashtë vendit me të gjitha klasat e furnizimit, me transport, mirëmbajtje dhe riparim;

- Mbështet me shërbime fushore operacionet dhe stërvitjet e FA brenda dhe jashtë vendit;

- Mbështet FA me infrastrukturë, kërkim, zbulim, çminim, asgjësim të municioneve të rrezikshme dhe lëndëve plasëse në operacione brenda dhe jashtë vendit;

- Kryen operacione humanitare, operacione kërkim-shpëtimi dhe operacione në raste emergjencash civile në bashkëpunim me autoritet civile;

- Administron të gjitha klasat e furnizimit;

- Administron dhe menaxhon municionet, armatimin, teknikën dhe rezervën e FA;

- Siguron mbështetjen e strukturave të Forcave të Armatosura me riparime, mirëmbajtje të përgjithshme të specializuara të pajisjeve, mjeteve motorike tokësore, në operacione brenda dhe jashtë vendit në kohë paqe krize, lufte dhe emergjencë civile;

- Siguron mbështetjen shëndetësore të përgjithshme për pjesëtarët e FA.

#### **5.4.1 Kapacitetet e mbështetjes**

Komanda Mbështetëse do të zhvillojë kapacitetet e saj për të siguruar mbështetjen logjistike, infrastrukturë, xhenio-EOD, shërbim shëndetësor dhe shërbime të tjera në interes të plotësimit të misionit dhe detyrave të FA. Në bashkëpunim me strukturat e tjera të FA, ajo do të sigurojë edhe kapacitetet e nevojshme mbështetëse për kryerjen e operacioneve ushtarake për përballimin e emergjencave civile, kërkim-shpëtimi dhe për operacione humanitare në ndihmë të komunitetit. Këto kapacitete do të sigurohen nëpërmjet strukturave të mëposhtme:

*Batalioni i Furnizimit* siguron mbështetjen me furnizime (klasa I-V), si ushqime, materiale, veshmbathje, pajisje personale, pjesë këmbimi, karburante, armatime, si dhe mbështetjen me shërbime të FA për realizimin e aktivitetit të përditshëm dhe zhvillimin e operacioneve ushtarake. Këto kapacitete do të përfshijnë marrjen, magazinimin, administrimin, shpërndarjen sipas klasave të furnizimit dhe sigurimin e shërbimeve fushore. Kapacitetet e batalionit të furnizimit do të jenë depot e përhershme të furnizimit edhe ambientet për vendosjen dhe magazinimin e materialeve të tepërta dhe skrapit.

*Batalioni i Transportit* siguron mbështetjen me transport tokësor të personelit dhe të materialeve në FA në veprimtaritë e përditshme dhe operacionet brenda dhe jashtë vendit. Për përmbushjen e misionit dhe detyrave që ka kjo njësi, është i domosdoshëm modernizimi me mjete transporti me rrota dhe mjete speciale në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

*Batalioni i Xhenios* siguron kapacitete për ndërtimin e objekteve dhe infrastrukturës stërvitore, rrugëve, shesheve, rrjeteve të kanalizimeve, rrjeteve elektrike e hidraulike për mbështetjen e operacioneve dhe përmirësimin e kushteve të punës, stërvitjes dhe jetesës së personelit në FA. Për rritjen e kapaciteteve, në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, është i domosdoshëm modernizimi me makineri speciale, sisteme dhe pajisje për mbështetjen dhe kryerjen e operacioneve të emergjencave civile, humanitare dhe në ndihmë të popullsisë civile.

Kjo strukturë siguron edhe kapacitete të asgjësimit të municioneve dhe eksplozivëve (AME) për zbulimin, trajtimin, demontimin ose asgjësimin e municioneve të rrezikshme dhe lëndëve plasëse në ambientet ushtarake apo civile, si dhe gjatë zhvillimit të operacioneve ushtarake të FA.

*Qendra e Riparimit dhe Mirëmbajtjes së Teknikës së FA* siguron kapacitete për mbështetjen e strukturave të Forcave të Armatosura me riparim-mirëmbajtje të përgjithshme dhe të specializuara të pajisjeve ushtarake, të mjeteve motorike tokësore, si dhe kapacitete të kontrollit, vlerësimit dhe certifikimit të pajisjeve në përdorim të FA.

*Batalioni i Mbështetjes Rajonale* siguron kapacitetet për mbështetjen e operacioneve të emergjencave civile, kërkim-shpëtimin dhe humanitare, të cilat kryhen në bashkëpunim me strukturat e tjera ushtarake e civile. Kjo strukturë do të sigurojë kapacitete të vendosura në rajone të ndryshme të vendit e të plotësuara me

personel e pajisje të lëvizshme për t'u përgjigjur në mënyrë të menjëhershme në fazën fillestare të operacioneve apo krizave, sipas Planit Kombëtar të Emergjencave Civile. Për të siguruar mbështetjen e saj në realizimin e detyrave, është domosdoshmëri kompletimi me pajisje speciale për kërkim-shpëtimin në periudhën afatmesme.

Qendra Stërvitore (QS) siguron trajnimin, stërvitjen dhe kualifikimin e oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të strukturave të FA në specialitetet logjistike si: furnizim, transport, mirëmbajtje, xhenio, personel-administratë, armatim-municioni dhe shëndetësi. Për të siguruar plotësimin e misionit dhe realizimin e detyrave, QS do të modernizohet dhe do të kompletohet me pajisje mësimore logjistike në periudhën afatmesme.

Spitali Ushtarak i FA siguron mbështetjen mjekësore Rol 2 për parandalimin e sëmundjeve apo epidemive, trajtimin e të plagosurve në operacione ushtarake brenda dhe jashtë vendit, si dhe në emergjencat civile. Kjo strukturë siguron edhe kapacitete për përgatitjen e personelit mjekësor ushtarak për të vepruar në përbërje të formacioneve ushtarake. Për përmbushjen e detyrimeve për mbështetjen me shërbim mjekësor në operacione, kjo strukturë është e domosdoshme të kompletohet me pajisje fushore apo module mjekësore në periudhën afatgjatë.

Për të siguruar koordinimin, bashkëveprimin dhe integrimin e të gjitha elementeve të mbështetjes logjistike, përveç strukturave dhe kapaciteteve të mësipërme, FA do të angazhojë edhe struktura e tjera të mbështetjes, si Qendrën e Menaxhimit të Materialeve, Laboratorin e FA dhe elementet e mbështetjes së vendit pritës (HNS), duke i integruar të gjitha këto kapacitete në një program të automatizuar.

Batalioni i armatimit ruan dhe administron armatimin dhe municionin rezervë të FA dhe në vitin 2016 do të kalojë në varësi të Batalionit të Furnizimit, i cili do të përgjigjet dhe për klasën V të furnizimit.

#### **Kapacitetet e mbështetjes për angazhime në operacione**

Në përmbushje të detyrimeve të Aleancës, FA krijon kapacitete mbështetëse për pjesëmarrje në operacione si më poshtë:

Kapacitete për dislokimin dhe ridislokimin e forcave. Kjo mbetet një kërkesë e përhershme për përmbushjen e misioneve në kushtet kur FA po angazhohen gjithnjë e më shumë në operacione jashtë vendit, në kuadrin e operacioneve të NATO-s, BE-së dhe OKB-së. Sigurimi i kapaciteteve të transportit strategjik të trupave për dislokimin, ridislokimin apo realizimin e rotacionit do të realizohet nëpërmjet marrëveshjeve dhe kontratave të veçanta.

Kapacitete të gatshme për dislokim. Këto konsistojnë në krijimin e elementeve të grupit të kontrollit të lëvizjes, të kapaciteteve të mbështetjes mjekësore, të kapaciteteve xheniere dhe EOD, si dhe kapaciteteve të veçanta për mbrojtjen kimike, bakteriologjike, radiologjike dhe nukleare (CBRN).

#### **5.4.2 Planet e zhvillimit të kapaciteteve të mbështetjes**

Komanda Mbështetëse do të zhvillojë kapacitetet e saj sipas periudhave të mëposhtme:

##### **Në periudhën 2016-2018**

Në këtë periudhë është i domosdoshëm kompletimi dhe modernizimi i Batalionit të Mbështetjes Rajonale me makineri e pajisje speciale të ndërveprueshme dhe të kompletohet njësia EOD.

Përmirësimi i infrastrukturës aktuale do të ndikojë në sigurimin e kapaciteteve mbështetëse logjistike për jetesë, punë e stërvitje të strukturave të FA. Nëpërmjet tyre do të sigurohen kapacitetet e mjaftueshme për administrimin e teknikës, sistemeve dhe pajisjeve të FA, duke i bërë ato më efikente për mbështetjen logjistike. Projektet kryesore që do të zbatohen do të jenë:

- Mjete e pajisje speciale për operacionet EOD;
- Pajisje kërkim-shpëtim;
- Rikonstruktion i grup depone në Qafë-Mollë, sistemeve infrastrukturore dhe ndërtim objekti shumëfunksional.

*Rezultatet e pritshme do të jenë:*

- Do të përmirësohen kushtet për administrimin e materialeve dhe pajisjeve;
- Do të përmirësohet infrastruktura ekzistuese, kushtet e punës, të jetesës dhe të gatishmërisë për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e materialeve, teknikës dhe pajisjeve.

##### **Në periudhën 2019-2021**

Gjatë kësaj periudhe do të vijojnë që të zhvillohen kapacitetet e sigurisë dhe ruajtjes, të rriten kapacitetet transportuese dhe të përmirësohen standardet për punë e jetesë të efektivave të FA, duke synuar arritjen e kapaciteteve të kërkuara nga Aleanca, si dhe arritjen e standardeve të sigurisë së infrastrukturës në FA. Është e domosdoshme që në këtë periudhë të zbatohen projektet e mëposhtme:

- Pajisje sigurie;

- Mjete transporti dhe speciale për batalionin e transportit;
- Pajisje detashmenti CIMIC për EOD;
- Rikonstruksion i objektit nr. 2 Pogradec;
- Rikonstruksion i 2 parqeve për automjetet në Pezë-Helmës;
- Rikonstruksion grup-depo Mirakë;
- Rikonstruksion i depove dhe godinës DMR Gjirokastër;
- Rikonstruksion i depove dhe godinës DMR Burrel.
- Makineri e pajisje xheniere për batalionin e xhenios;
- Pajisje kërkim-shpëtimi për Batalionin e Mbështetjes Rajonale;
- Ndërtim i poligonit kombëtar në Fekën dhe Bizë;
- Përmirësim infrastrukture, rezidenca Pogradec.

#### Rezultatet e pritshme do të jenë:

- Do të rritet dhe garantohet sigurimi i ambienteve nëpërmjet monitorimit të pajisjeve me sistemeve moderne ruajtje;
- Do të rriten kapacitetet transportuese në mbështetje të operacioneve të FA brenda dhe jashtë vendit;
- Do të përmirësohen infrastruktura ekzistuese, kushtet e punës, të jetesës, gatishmërisë, ruajtjes e mirëmbajtjes së materialeve, teknikës dhe pajisjeve;
- Do të përmirësohen ndjeshëm kapacitetet e KM për realizimin e operacioneve luftarake, operacione të kërkim-shpëtimit në ndihmë të komunitetit dhe në mbështetje të emergjencave civile;
- Do të rriten kapacitetet transportuese në pajisje dhe teknikë në mbështetje të operacioneve të FA brenda dhe jashtë vendit;
- Do të krijohen kapacitetet e nevojshme për vetëzhvendosjen në zonën e operacionit;
- Do të sigurohet ndërveprueshmëria në operacione të përbashkëta me vendet partnere.

#### **Në periudhën 2022-2025**

Sigurimi dhe kompletimi i KM me makineri e pajisje, pajisje sigurie dhe investimet në infrastrukturën ekzistuese do të rritin kapacitetet e sigurisë dhe do të përmirësojnë kushtet e punës, të jetesës, të gatishmërisë, të ruajtjes së materialeve dhe teknikës në FA. Prioritet gjatë kësaj periudhe do të jenë:

- Pajisje sigurie për kontrollin e hyrje-daljeve dhe monitorimin e ambienteve;
- Pajisje sigurie për depo;
- Mjete speciale, si autovinç i rëndë (5-15 tonë) dhe automjet zjarrfikës;
- Sistemim dhe asfaltim i rrugëve dhe shesheve në territorin e parkut;
- Ndërtim ujësjellësi në repartin 4030;
- Rikonstruksion i grup depove në Vaqarr.

#### Rezultatet e pritshme do të jenë:

- Do të rritet dhe do të garantohet sigurimi i ambienteve dhe depove të materialeve nëpërmjet monitorimit të pajisjeve me sistemeve moderne sigurie;
- Do të rriten kapacitetet për përpunimin e materialeve ushtarake dhe emergjencës civile në raste zjarri;
- Do të përmirësohet infrastruktura ekzistuese, kushtet e punës, të jetesës, gatishmërisë, ruajtjes e mirëmbajtjes së materialeve, teknikës dhe pajisjeve.

**5.5 Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS)** përbëhet nga Komanda dhe Shtabi, Kompania e Mbështetjes së Shtabit, Akademia e Forcave të Armatosura, Akademia e Nënoficerëve, Shkolla e Trupës dhe Qendra e Stërvitjes Individuale, Qendra e Doktrinëve dhe Kërkimit dhe Qendra e Simulimit.

*KDS përgjigjet për arsimimin, kualifikimin dhe trajnimin e oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve / detarëve dhe civilëve të të gjitha niveleve, mbështetjen e stërvitjeve të strukturave të FA dhe zhvillimin e koncepteve doktrinale e studimeve strategjike.*

Për plotësimin e misionit KDS zbaton këto detyra kryesore:

- Realizon arsimimin, stërvitjen, trajnimin dhe kualifikimin individual të personelit ushtarak dhe civil të FA;
- Përgatit planet dhe programet e arsimimit, trajnimit dhe stërvitjes dhe ndjek realizimin e tyre;
- Mbështet trajnimin dhe stërvitjen e komandave dhe shtabeve të FA nëpërmjet programeve të simulimit;
- Zhvillon konceptet dhe doktrinën e FA;
- Ndjek standardizimin dhe mësimet e nxjerra.

KDS zotëron kapacitetet për zhvillimin e përditësimin e doktrinëve, programeve arsimore dhe koncepteve paralelisht me zhvillimin apo përmirësimin e kapaciteteve. Konceptet, programet dhe doktrinën do të zhvillohen duke vlerësuar ato aktuale dhe duke përcaktuar mundësitë e rritjes së efektivitetit dhe

ndërveprueshmërisë, me qëllim që kapacitetet e krijuara të përmbushin misionin dhe të adresojnë rreziqet e së ardhmes. Zhvillimi i doktrinave dhe koncepteve do të mbështetë ndërveprimin me aleatët dhe midis forcave dhe shërbimeve, duke i paraprirë modernizimit apo duke reflektuar mësimet e nxjerra.

KDS do të përmirësojë kapacitetet e nevojshme për arsimimin, stërvitjen dhe zhvillimin individual të të gjithë personelit të FA në kurset institucionale në AFA, ANO, SHT dhe QSK, si dhe do të përmirësojë dhe do të rrisë kapacitetet e saj për trajnime në kurset funksionale, duke përmbushur të gjitha nevojat e FA. KDS, përtej kualifikimit të specialistëve, do të përmirësojë kapacitete për të trajnuar trajnuesit, duke i paraprirë të gjitha nevojave që do të kenë FA, përjashtuar specialitetet specifike (mjekë apo juristë).

Në periudhën e mbuluar nga PAZHFA do të vijojë transformimi dhe konsolidimi i sistemit arsimor në KDS nëpërmjet planeve, programeve dhe metodologjive mësimore bashkëkohore të ndërveprueshme me ato të vendeve të NATO-s. KDS do të aplikojë teknologjinë si një mundësi për të zgjeruar rrjetet e informacionit dhe ofruar njohuri (doktrinat, konceptet) në vendin dhe kohën ku ato nevojiten. Literatura do të jetë e disponueshme për gjithë personelin ushtarak dhe civil të FA nëpërmjet Bibliotekës Dixhitale, e cila do të pasurohet në vijimësi.

Programet dhe kurrikulat e arsimimit dhe trajnimit të përgjithshëm e special do të plotësojnë kërkesat për formimin e aftësive bazë në nivel strategjik, operacional dhe taktik, si dhe cilësive të lidershit dhe performancës, të përcaktuara sipas niveleve përkatëse. Një pjesë e programeve të arsimimit dhe trajnimit individual të oficerëve dhe nënoficerëve do të zhvillohen në gjuhën angleze.

Arsimimi i oficerëve është një proces i vijueshëm që fillon me ditën e rekrutimit dhe përfundon në ditën e largimit prej tyre nga FA. Zhvillimi profesional i oficerëve kalon nëpër fazën e testimit përzgjedhës të kandidatëve, fazën e stërvitjes ushtarake bazë, arsimimin special profesional, arsimimin bazë, studimet e thelluara, programin paraprak të studimeve të mbrojtjes, programin e studimeve të thelluara në fushën e mbrojtjes, programin e studimeve të thelluara në fushën e sigurisë.

**Akademia e Forcave të Armatosura** është institucioni përgjegjës për hartimin dhe realizimin e programeve të arsimimit dhe kualifikimit për personelin ushtarak e civil. Në planin afatshkurtër do të vijojë rishikimi i programeve, me qëllim përafrimin e tyre me programet e akademive të vendeve të tjera aleate, përgatitja e materialeve e teksteve mësimore dhe shfrytëzimin e teknologjive për krijimin e informacionit të disponueshëm on-line.

**Qendra e Gjuhëve të Huaja** është kapaciteti i vetëm i aftë dhe i autorizuar për zhvillimin e programeve, procedurave dhe standardeve të testimit në MM, në interes të objektivave të FA dhe angazhimeve në strukturat e Aleancës. Kjo qendër do të vijojë të plotësojë të gjitha kërkesat dhe nevojat e FA, duke realizuar të gjitha kurset e kërkuara mbi nivelin 1 deri në nivelin 3 të gjuhës angleze, si dhe kurse intensive për gjuhët gjermane, frënge, italiane, turke dhe greke.

**Akademia e Nënoficerëve** harton dhe realizon programet e arsimimit të përgjithshëm profesional gjatë gjithë karrierës së nënoficerëve. Arsimimi special kryhet në Shkollën e Trupës ose në Qendrat Stërvitore të Forcave dhe Komandave, sipas programeve të miratuara. Arsimimi dhe trajnimi i nënoficerëve do t'i pajisë ata me cilësitë dhe aftësitë e nevojshme profesionale për drejtimin, komandimin, stërvitjen dhe administrimin e nënrepartëve dhe mbështetjen e zinxhirit të komandimit.

Arsimimi dhe trajnimi individual i personelit nënoficer përfshin kursin fillestar të nënoficerit, kursin bazë të nënoficerit, kursin e avancuar të nënoficerit, kursin e lartë të nënoficerit dhe kursin e kryekapiterit.

**Shkolla e Trupës dhe Qendra e Stërvitjes Individuale** do të përmirësojë kapacitetet e saj për trajnimin fillestar dhe kualifikimin profesional, sipas specialiteteve të kandidatëve për oficerë, nënoficerë dhe ushtarëve/detarëve. Ajo do të vijojë të ndjekë programin e arsimimit dhe kualifikimit të personelit që realizohet nga institucione të tjera jashtë FA. Ky arsim do të vijojë arsimin e përgjithshëm ushtarak, për të formuar me cilësitë dhe aftësitë e nevojshme profesionale specialistët e trupës, armës apo shërbimit.

Në shkollën e Trupës dhe Qendrën e Stërvitjes Individuale, edhe për vitet në vazhdim, me ushtarët/detarët do të zhvillohet kursi i stërvitjes individuale bazë dhe kursi i stërvitjes individuale të avancuar.

**Qendra e Simulimit** do të modernizohet në infrastrukturë, pajisje, programe dhe do të kompletohet me personel të aftë për të zhvilluar dhe përmirësuar kapacitetet ekzistuese. Ajo do të mundësojë hartimin në kohë reale të kërkesave sfiduese, krijimin e kapaciteteve trajnuese dhe mjedisit specifik, realist e ndërveprues virtual të kërkuar prej situatës taktike për të trajnuar dhe zhvilluar personelin ushtarak, drejtuesit dhe njësitë e FA për të arritur gatishmërinë e kërkuar apo për të mbajtur atë ekzistuese.

Trajnimi i ofruar do të jetë nga niveli i stërvitjes individuale, kolektive deri në stërvitjet e përbashkëta dhe

shumëkombëshe. Në planin afatmesëm, kjo qendër simulimi është e domosdoshme të zotërojë kapacitete të plota për të përgatitur dhe simuluar trajnimin virtual për çdo lloj operacioni dhe do të mund të funksionojë si qendër rajonale simulimi për t'u shfrytëzuar në kuadrin e bashkëpunimit me vendet e tjera.

#### **5.6. Stërvitja**

FA me asetet dhe kapacitetet e saj vazhdojnë të përmbushin me sukses detyrimet kushtetuese në mbrojtjen e sovranitetit dhe të integritetit territorial, përballimin e emergjencave civile dhe dhënien e ndihmës në mbështetjen e autoriteteve civile. Misioni e detyrat e mësipërme, përveç natyrës së tyre rutinë dhe nevojës për kapacitete fleksibël, baza kryesore e përmbushjes së tyre duhet të jetë stërvitja e vazhdueshme dhe intensive.

FA janë angazhuar denjësisht në operacionet brenda vendit dhe ato të udhëhequra nga NATO dhe BE. Ky angazhim i rëndësishëm do të vazhdojë edhe për vitet në vazhdim, gjë që detyron komandat kryesore dhe repartet të mbështetnin operacionet me forca, mjete e kontingjente të afta, të përgatitura e të stërvitura mirë.

Objektivat e kapaciteteve të FA-ve, repartet dhe nënrepartet e deklaruar si pjesë e kapaciteteve të NATO-s (kompania NRF, toga e PU, repartet e deklaruar në NATO "Pool of Force"), do të përbëjnë një drejtim të rëndësishëm ku do të bazohet dhe udhëhiqet stërvitja.

Stërvitja mbetet faktori kryesor për shndërrimin e një formacioni ushtarak në një forcë të aftë dhe operacionale. Stërvitja do të jetë qendra e gravitetit e veprimtarisë së FA-së. Për vitet në vazhdim në të gjitha nivelet e drejtimit në FA do të vijojë standardizimi dhe konsolidimi i sistemit të stërvitjes individuale dhe asaj kolektive, në funksion të përmbushjes së misioneve dhe detyrave të sotme dhe të ardhshme të FA-së në planin kombëtar dhe ndërkombëtar.

#### **Prioritetet e stërvitjes do të jenë:**

Stërvitje për rritjen e kapaciteteve operacionale në funksion të gatishmërisë luftarake;

Stërvitje paradislokuese e nënreparteve që përgatiten për dislokim në zonën e operacioneve;

Stërvitje për emergjencat civile për përballimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore dhe atyre të shkaktuara nga dora e njeriut;

Stërvitje për konsolidimin e përdorimit të forcave sipas konceptit "Join" që, për kushtet e FA, do të konsiderohet stërvitja e "Task-Force".

**Trajnimi dhe stërvitja e personelit dhe reparteve që dislokohen në operacione nën drejtimin e NATO-s.** Forcat që do të marrin pjesë në misione jashtë vendit të përzgjidhen, të trajnohen, të stërviten dhe të pajisen për kryerjen me profesionalizëm të lartë të detyrave sipas specifikave dhe kërkesave operacionale të misionit.

Trajnimi i kontingjenteve që do të marrin pjesë në mision do të fillojë 120 ditë përpara nga koha e dislokimit në zonën e operacionit (D-120) dhe do të mbarojë 30 ditë përpara dislokimit (D-30).

**Poligonet e qitjes dhe stërvitjes.** Në interes të përgatitjes e trajnimit të plotë të efektivave në strukturat e FA-së, do të shfrytëzohen poligonet aktuale të miratuara kombëtare dhe lokale, si dhe hapësirat e stërvitjes brenda apo në afërsi të venddislokimeve, stërvitet në klasa e kabinete dhe në qendrën e simulimit, si dhe laboratorë të ndryshëm. Poligonet e stërvitjes dhe qitjes të miratuara për këtë qëllim duhet të plotësojnë kërkesat dhe standardet për përgatitjen e efektivave.

#### **Në periudhën 2016-2018**

Prioritet do t'i jepet përmirësimit të infrastrukturës së poligoneve dhe hapësirave stërvitore, veçanërisht poligonit të qitjes dhe stërvitjes së Vaut të Dejës, Shkodër dhe Poshnjës, Berat. Investimi në infrastrukturën e këtyre poligoneve dhe hapësirave stërvitore do të bëhet duke shfrytëzuar kapacitetet dhe mundësitë e strukturave të FA-së.

#### **Në periudhën 2019-2021**

Nisur nga kërkesat dhe nevojat e strukturave të Forcave të Armatosura për zgjerimin e rajoneve stërvitore dhe poligoneve të qitjes dhe stërvitjes, është parashikuar ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së poligonit të qitjes dhe stërvitjes në garnizonin e Zallherit, Tiranë. Në këtë poligon është parashikuar ndërtimi i poligoneve të qitjeve me të gjitha llojet e armëve të këmbësorisë deri në distancë 300 m, si dhe ndërtimi i rajonit të stërvitjes në nivel kompaktësimi kompanie. Ndërtimi i këtij poligoni dhe rajoni stërvitor sipas standardeve të NATO-s do të përmirësojë dhe do të rritë ndjeshëm nivelin e përgatitjes së efektivave. Ky poligon do të përdoret nga të gjitha strukturat e FA-së dhe nga strukturat e tjera shtetërore.

#### **Në periudhën 2022-2025**

Prioritet do të ketë ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së poligonit kombëtar Bizë. Ndërtimi i këtij poligoni është i domosdoshëm për stërvitjen e FA dhe strukturave të tjera shtetërore. Në këtë poligon është

parashikuar ndërtimi i poligoneve të qitjes me të gjitha llojet e armëve të këmbësorisë, poligon për stërvitje xheniere dhe asgjësim municionesh dhe eksplozivëve, poligon për qitje kundër mjeteve të blinduara, si dhe rajone stërvitore për stërvitje dhe kompaktësim të nënrepartëve dhe repartëve deri në nivel batalioni, rajon stërvitor për stërvitje xheniere, kundër kimike, bakteriologjike etj.

### **5.7 Kapacitete të tjera mbështetëse**

Kapacitetet e tjera mbështetëse janë strukturat që sigurojnë mbështetjen me shërbime të tjera të nevojshme për funksionimin e Forcave të Armatosura. Ato janë QBO, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Policia Ushtarake, Qendra e Menaxhimit të Materialeve dhe Laboratori Qendror i FA, Qendra e Kulturës, Medies, Botimeve të Mbrojtjes, Muzeu i FA dhe Shtëpitë e Pushimit, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Ndërmarrja MEICO, Drejtoria e Shifrës, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, Qendra e Personel- Rekrutimit, Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm, Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, Uzina e Lëndëve Plasëse, Mjekës, Elbasan, Uzina Mekanike, Gramsh, Kombinati Mekanik, Polican. Një pjesë e këtyre kapaciteteve janë përshkruar në strukturat e komandim-kontrollit.

#### **5.7.1 Policia Ushtarake**

Misioni i Policisë Ushtarake (PU) është ruajtja e rendit ushtarak në FARSH, zbulimi, parandalimi, ndjekja e veprimtarisë kriminale, angazhimi në luftën kundër terrorizmit, marrja pjesë në operacionet paqeruajtëse dhe humanitare, si dhe mbrojtja e pronës shtetërore në administrim dhe përdorim të Forcave të Armatosura nga veprimet e kundërligjshme.

Me qëllim përmbushjen e misionit dhe detyrave, Policia Ushtarake zotëron dhe do të përmirësojë kapacitetet e saj për mbështetjen e luftimit dhe operacioneve.

Objekti i Policisë Ushtarake në periudhën 2016-2025 është zotërimi i kapaciteteve efektive për të ofruar mbështetje të operacioneve, duke siguruar nivel të lartë gatishmërie dhe fleksibilitet për t'u përshtatur për misione të ndryshme në çdo lloj mjedisi.

Si përforcues i kapaciteteve luftarake të FA, PU do mundësojë mbështetjen e komandantëve të njësisë të luftimit me funksionet e Policisë Ushtarake dhe integrimin e përpjekjeve me njësitë dhe elementet e tjera të mbështetjes së luftimit dhe mbështetjes me shërbime të luftimit. Funksionet bazë të PU janë: mbështetja e manovrës dhe lëvizjes, sigurimi i zonës, sigurimi i zhvendosjes së forcave, ligjshmëria dhe operacionet e inteligjencës policore.

PU do të ketë në fokus zhvillimin dhe përmirësimin e kapaciteteve për angazhim në luftën kundër terrorizmit dhe pjesëmarrje në operacione brenda dhe jashtë vendit. Për angazhimet brenda vendit, PU do të përmirësojë kapacitetet që zotëron për shoqërimin, mbështetjen dhe përshejtimin e transportit të personelit, sigurinë dhe ruajtjen e forcave, mbledhjen dhe sigurimin e informacioneve policore e të zbulimit, ruajtjen e rendit ushtarak, mbrojtjen e pronës shtetërore në administrim e përdorim të FA dhe garantimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e FA.

Kapacitetet e PU do të jenë të afta për të operuar ditën dhe natën, në lloje të ndryshme terreni dhe në të gjitha kushtet e motit.

Personeli do të trajnohet dhe aftësohet për përdorimin e forcës, armëve dhe teknologjive vdekjeprurëse dhe jovdekjeprurëse, për grumbullimin dhe shpërndarjen e informacionit, për ruajtjen dhe sigurimin e personelit, të materialeve dhe mjeteve luftarake nga sulmet armike në prapavijë, për grumbullimin, evakuimin, ruajtjen dhe sigurimin e robërve të luftës, si dhe të personelit civil të ndaluar.

#### **5.7.2 Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake**

Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU) është institucioni që siguron të dhënat hapësinore dhe mbështetjen e veprimeve ushtarake dhe operacioneve të FA në fushat e Gjeodezisë, Hartografisë, Fotogrametrisë dhe Remote-sensing-ut, si dhe kërkesave për studimin, projektimin, standardizimet dhe certifikimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe atyre të perspektivës. IGJIU përgjigjet për hartografinë masiv tokësor, detar dhe ajror të RSH dhe është autori i ndërtimit të rrjeteve gjeodezike.

IGJIU është institucion shkencor dhe shërben si Agjenci Hartografike Kombëtare, duke realizuar kërkesat në shërbim të të gjitha institucioneve shtetërore që kërkojnë mbështetjen me produktet specifike të saj, të tilla si: harta, rievime (punime në terren), nxjerrje koordinatash, bashkëpunime për projekte të ndryshme (me vendet fqinje), rievime dhe hartim dokumentacioni për pronat e FA, masterplane apo vendosje në dispozicion të informacionit arkivor të IGJIU për qëllime studimore.

Në IGJIU është ngritur infrastruktura e IT dhe rrjeti kompjuterik funksionon duke administruar në servera produktin dixhital. Në të ardhmen, pasi nga metodika shkencore analoge është kaluar në

metodikë dixhitale, do të investohet për realizimin, menaxhimin, vendosjen në dispozicion dhe shpërndarjen e gjeoinformacionit për FA, duke e modernizuar me pajisje dhe teknologji, si dhe me trajnimin dhe kualifikimin e personelit. Gjithashtu, do të vijojë pajisja me mjete dhe programet e domosdoshme për krijimin e procesit të automatizuar dhe të mbyllur për krijimin e hartës dixhitale dhe bazës për të dhënat gjeohapësinore, pa lënë pas dore edhe trajnimin për përdorimin e pajisjeve dhe programeve, gjë që ndikon në cilësinë, saktësinë dhe shpejtësinë e krijimit të hartës.

Proceset që aplikohen në IGJIU, po zhvillohen në përputhje me standardet e Aleancës në fushën e gjeoinformacionit, analizën e terrenit, si dhe krijimin e gjeo-databazës. Procesi i standardizimit në IGJIU do të vijojë edhe në fusha të tjera, të cilat janë përgjegjësi e saj.

Për zhvillimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të IGJIU do të realizohen projektet për ngritjen e infrastrukturës në sektorin e fotogrametrisë, ngritjen e serverit të Geographic Information System (GIS) në IGJIU dhe modernizimi e informatizimi i Arkivit të IGJIU.

Në periudhën afatshkurtër, programi kryesor që do të realizohet është projekti shqiptaro-norvegjez i informacionit hidrografik, i cili do të synojë krijimin e kapaciteteve për rilevime batimetrike, krijimin e hartave elektronike të lundrimit, hartave detare në letër dhe menaxhimin e shpërndarjen e të dhënave hapësinore detare dhe bregdetare.

### **5.8 Kapacitetet për përmbushjen e detyrimeve të Aleancës**

Anëtarësimi në NATO ka përfitimet, por dhe detyrimet që rrjedhin prej tij. Pjesë përbërëse e angazhimit në kuadër të NATO-s është unifikimi i procesit të planifikimit të mbrojtjes, si dhe pjesëmarrja në operacione të përbashkëta. Një prej instrumenteve që mundëson këtë angazhim është paketa e objektivave të kapaciteteve. Ato janë kapacitete ushtarake dhe civile që NATO ia kërkon Shqipërisë për t'i ngritur dhe zhvilluar për të përmbushur nivelin e ambicies. Këto kapacitete i caktohen vendeve nga NATO sipas mundësisë dhe kapaciteteve të çdo vendi "*fair burden - share reasonable challenge*". Ato kanë për qëllim rritjen e kapaciteteve dhe aftësive të Forcave të Armatosura të një vendi anëtar të NATO-s, për të arritur ndërveprueshmëri dhe mbështetje reciproke.

Shqipëria e ka marrë zyrësisht këtë paketë në vitin 2013. Nëpërmjet kësaj pakete kërkohet që të përmbushen objektiva sasiore dhe cilësore, ndarë në tri periudha (periudhë afatshkurtër 0-6 vjet, afatmesme 7-15 vjet dhe afatgjatë mbi 15 vjet). Kapacitetet sasiore kërkojnë ngritjen, trajnimin dhe certifikimin e një grup batalioni të këmbësisë dhe grupi të operacioneve speciale tokësore për t'i pasur të gatshme për operacione të udhëhequra nga NATO për një periudhë afatshkurtër, kurse në periudhën afatmesme dhe afatgjatë kërkohet përmirësimi i aftësive të këtyre reparteve dhe nënreparteve. Kërkesat cilësore kërkojnë modernizimin e sistemeve të ndryshme, kryesisht për periudhën afatshkurtër, kurse në periudhën afatmesme dhe afatgjatë kërkohet përmirësimi i aftësive, përputhshmëria dhe integrimi i këtyre sistemeve me sistemet e strukturave të NATO-s.

Sikurse është theksuar më sipër, kapacitetet do të zhvillohen të orientuara nga parimi i "*një grupimi të vetëm forcash*" (*Single Set of Forces*), të afta për të garantuar përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe detyrimeve për mbrojtjen kolektive në kuadër të Aleancës. Në përmbushje të këtij parimi, kapacitetet e kërkuara si detyrim për Aleancën janë prioritarizuar, detajuar dhe integruar në planet e zhvillimit të FA, sipas strukturave dhe periudhave të përshkruara më lart.

## **KREU VI BURIMET E MBROJTJES**

### **6.1 Burimet njerëzore**

Burimet njerëzore janë komponenti më i rëndësishëm i burimeve të mbrojtjes dhe elementi themelor i kapaciteteve. Aktualisht FA zotëron kapacitetet njerëzore dhe sistemin e automatizuar të menaxhimit të personelit, i cili do të vijojë të shërbejë për ndjekjen e kompletimit me personel, gatishmërisë dhe mirëqenies së FA. Përmirësimi i kapaciteteve do të realizohet nëpërmjet transformimit të sistemit të automatizuar të menaxhimit të personelit, si dhe programeve, politikave dhe procedurave.

Konsolidimi i strukturës së FA, përmirësimi e plotësimi i procedurave, planeve dhe programeve për menaxhimin e integruar të përbërësve të ciklit jetësor të personelit, në zbatim të ligjit për gradat dhe karrierën ushtarake në FA, do të përbëjnë drejtimin kryesor të menaxhimit të personelit për të gjitha strukturat e FA.

Menaxhimi i personelit do të vazhdojë të synojë në mbështetjen e strukturës së FA me resurset e nevojshme njerëzore në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e misionit.

Transformimi dhe zhvillimi i personelit do të realizohet në mënyrë të përhershme në katër komponentë

kryesorë:

- Përmirësimi i procedurave dhe proceseve të menaxhimit të personelit, i cili do të realizohet me njohjen në kohë reale të kërkesave për personel, gjendjes faktike dhe përmbushjes së nevojave sipas specialiteteve, gradave dhe moshës. Evidentimi i nevojave të shtrira në vite dhe mundësive do të ofrojë hapësirat e planifikimit në kohë për të mbushur boshllëqet e evidentuara.

- Sistemi automatik i menaxhimit të burimeve njerëzore do të zgjerohet dhe do të shfrytëzohet për të mbështetur proceset që kryhen prej personelit dhe zinxhirit të komandimit derisa arrin në nivelin e autoritetit miratues. Rezultati i synuar do të jetë thjeshtësimi i praktikave, duke e bërë procesin më të shpejtë e të saktë, të përshtatshëm për të përmbushur nevojat. Kualifikimi, emërimi dhe gradimi i personelit do të bazohen në potencialin e vlerësuar kryesisht prej të dhënave të evidentuara prej sistemit dhe performancës individuale dhe kolektive.

- Teknologjitë në rrjet do të zgjerojnë rolin në menaxhimin e personelit, duke rritur funksionet e informimit dhe shkëmbimit interaktiv të informacionit. Po në rrjet mund të ndiqet statusi i vlerësimit të ushtarakut dhe përcjellja e pasqyrimi i tyre në dosje do të mund të bëhet verifikimi i dokumenteve dhe të dhënave personale dhe përditësimi i tyre në dosjen zyrtare, do të mundësohet komunikimi nëpërmjet e-mailit dhe do të ofrohet akses i një sasive të konsiderueshme informacioni nëpërmjet rrjetit. Rrjeti do mundësojë deklarimin e nevojave dhe preferencave për emërimet, arsimin e kualifikimit dhe informimin për mundësitë për arsimim.

- Përmirësimi i sistemit të të dhënave të personelit (*data base*) për të rritur saktësinë e të dhënave dhe për të mundësuar mbajtjen, llogaritjen, evidentimin e personelit dhe ofrimin e gjithë informacionit të nevojitur për ushtarakët sipas specialiteteve, kualifikimit, përgatitjes për emërimet, dislokim, arsimim, gradim dhe për të ndihmuar në vendimmarrjen operacionale.

**Prioritetet e zhvillimit të personelit të FA.** Zhvillimi i mëtejshëm i forcës profesionale, duke rritur vlerat, kulturën dhe aftësitë operacionale për përmbushjen e misionit dhe detyrave, do të vazhdojë të jetë prioritet edhe në këtë periudhë. Përmirësimi i cilësive të forcës profesionale do të arrihet nëpërmjet menaxhimit efektiv, zhvillimit (arsimimit) dhe mbështetjes së personelit.

Mbështetja e personelit do të realizohet nëpërmjet përmirësimit të trajtimit, përmirësimit të kushteve të jetesës, punës dhe shërbimit, kujdesit shëndetësor për ushtarakët dhe familjet e tyre dhe integritetit të ushtarakëve në shoqëri pas daljes nga radhët e FA.

Zhvillimi i lidershipit ushtarak për të gjitha nivelet dhe arsimimi i vazhdueshëm, të krahasueshëm me aleatët, mbetet një nga elementet më të rëndësishme e të vazhdueshme të FA. Objektivat prioritarë do të konsistojnë në rritjen e nivelit profesional, në menaxhimin e kategorive të tyre në mënyrë progresive, në përmbushjen e standardeve, në konsolidimin e procesit të zhvillimit profesional, si dhe ecurinë në karrierë.

Rëndësi e veçantë do t'u kushtohet specialiteteve, të cilat në Forcat e Armatosura janë drejt zhdukjes. Personelit, i cili i përket këtyre specialiteteve, do t'i mundësohet dhënia e një specialiteti të dytë, bazuar në eksperiencën në punë, kurset institucionale të kryera brenda e jashtë vendit, si dhe aftësitë e fituara gjatë edukimit ushtarak.

**Zhvillimi i burimeve njerëzore.** Numri i personelit të FA do të jetë 8500 veta dhe deri në vitin 2025 nuk parashikohet të ketë ndryshime. Personeli i FA do të zhvillohet sipas kategorive të mëposhtme:

Personeli oficer, sipas nevojave dhe planeve, në përputhje me kërkesat e funksioneve organike, specialitetin, gradën dhe funksionin. Ky proces do të mbajë në konsideratë arsimimin, kualifikimin dhe trajnimin e oficerëve brenda dhe jashtë vendit.

Personeli nënoficer, do të jetë produkt i përzgjedhjes së elementëve më të mirë të personelit ushtar/detar, i cili do të vijojë kualifikimin dhe arsimimin e mëtejshëm të tyre në institucionet arsimore ushtarake brenda dhe jashtë.

Personeli ushtar/detar, nëpërmjet një procesi të përshkallëzuar rekrutimi, stërvitjeje dhe trajnimi, duke u fokusuar në plotësimin e strukturave prioritare.

Personeli civil, nëpërmjet sistemit të rekrutimit, arsimimit dhe trajtimit, duke mbajtur parasysh kualifikimet arsimore në përputhje me funksionet organike.

## 6.2 Burimet materiale

Burimet materiale të FA do të shfrytëzohen për përmirësimin e kushteve për jetesë, stërvitje dhe operacione të efektivave dhe do të konsistojnë në afrimin e mbështetjes me shërbime fushore, furnizime, transport dhe mirëmbajtje. Këto kapacitete do të sigurohen nga vetë strukturat respektive, të ndihmuara nga Komanda Mbështetëse. Mbështetja do të realizohet nga lart poshtë, sipas konceptit të mbështetjes logjistike.

Mbështetja në operacione do të sigurohet edhe me marrëveshje me shtetet e tjera pjesëmarrëse në

operacionet e përbashkëta ose me agjencitë e mbështetjes të NATO-s.

QMM do të jetë struktura që do të menaxhojë gjendjen e rezervave dhe aktiveve në FA. Laboratori i FA do të kryejë analizat periodike për materialet dhe mallrat ushtarake, me qëllim sigurimin dhe garantimin e cilësisë dhe standardeve.

Zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës do të synojë ndërtimin e ambienteve të reja dhe përshtatjen e atyre ekzistuese, sipas normave dhe standardeve të ndërtimit bashkëkohor. Prioritet do të kenë investimet në infrastrukturë për krijimin e kushteve për jetesë, punë, mësim e stërvitje të personelit.

### **6.3 Burimet financiare**

Zhvillimi i kapaciteteve të FA është i lidhur ngushtë me mbështetjen dhe menaxhimin efektiv të burimeve financiare të kërkuara. Planifikimi financiar synon parashikimin afatgjatë për sigurimin e burimeve të kërkuara në kuadër të PAZHFA 2016-2025.

**Parashikimet e buxhetit të mbrojtjes 2016-2025.** Mbështetja me burime financiare e PAZHFA 2016-2025 do t'u referohet të dhënave makroekonomike të Ministrisë së Financave, me një tendencë rritjeje të zhvillimit të ekonomisë me ritme konstante. Mbajtja e një inflacioni të kontrolluar në nivel mesatar do të çojë në një rritje të buxhetit të mbrojtjes, duke ruajtur vlerat 1 për qind të GDP-së për vitet 2016-2018. Bazuar në dokumentin e Strategjisë Ushtarake, buxheti i mbrojtjes do të rritet gradualisht, duke arritur në 2 për qind të GDP-së, në vitin 2025, me qëllim përshpejtimin e procesit të zhvillimit të forcës së ardhshme.

PAZHFA 2016-2025 do të orientojë alokimin e burimeve në kategoritë kryesore të buxhetit: shpenzime personeli, shpenzime operationale dhe mirëmbajtje, modernizim e infrastrukturë dhe kërkim-zhvillim.

Ndarja në këto kategori i është referuar disa modeleve të një numri vendesh anëtare të NATO-s, si dhe rekomandimeve të RSM, duke synuar një ulje graduale të shpenzimeve të personelit, në mënyrë që pas vitit 2025 të arrijë në 35 për qind të buxhetit të mbrojtjes nga rreth 48 për qind që është aktualisht.

Shpenzimet në zërin "operacione dhe mirëmbajtje" do të tentojnë një ulje graduale, duke synuar që pas vitit 2025 të arrijnë shifrat 35 për qind nga 38,6 për qind që është aktualisht.

Në periudhën 2016-2025 do të synohet që shpenzimet për investime dhe pajisje-armatim të kenë rritje të vijueshme duke synuar arritjen e nivelit 30 për qind të buxhetit të mbrojtjes, nga 14 për qind që është aktualisht.

Alokimi i fondeve për punën kërkimore-shkencore planifikohet të fillojë rreth viteve 2018-2019, ndonëse në vite janë planifikuar, nuk ka pasur mbështetje financiare. Këto shpenzime do të mbështeten me burime financiare pas vitit 2020.

### **6.4 Organizimi i programeve të mbrojtjes**

Një nga proceset më të rëndësishme në sistemin e PPBES është ai i organizimit dhe hartimit të programeve të mbrojtjes, i cili përfaqëson mbështetjen me burime të të gjitha aktivitetëve të planifikuar për një periudhë 6-vjeçare. Programimi i burimeve të mbrojtjes siguron zhvillimin e FA sipas prioritetëve. Hartimi i programeve të mbrojtjes synon kthimin e objektivave të kapaciteteve, të prioritetëve dhe detyrave të parashikuara në dokumentet kryesore të planifikimit strategjik në programe shumëvjeçare të integruara në funksion të procesit të planifikimit të integruara (IPS) të Qeverisë Shqiptare. Në këtë kuadër, MM do të operojë me programe mbrojtjeje, të cilat do të jenë më fleksibël për t'u përshtatur sipas nevojave të zhvillimit të FA dhe kryesisht në modernizim dhe infrastrukturë.

Aktualisht, programet, me të cilat operon Ministria e Mbrojtjes, janë:

1. Programi i Planifikimit, Menaxhimit dhe Administrimit.
2. Programi i Forcave të Luftimit.
3. Programi i Mbështetjes së Luftimit.
4. Programi i Arsimimit.

Programet e mbrojtjes do të reflektojnë parashikimin e kërkesave të FA, si dhe do të orientojnë përdorimin sa më efektiv të burimeve të mbrojtjes, me synim zhvillimin e kapaciteteve operationale, arritjen dhe mbajtjen e niveleve të planifikuar të operacionalitetit, prioritetëve dhe objektivave, detyrimet kushtetuese të FA, mbështetjen e objektivave të RSM, paketës së objektivave të kapaciteteve dhe pjesëmarrjen në operacione.

Në fushën e stërvitjes, programet do të përqendrohen në mbështetjen me burime për të gjitha nivelet e stërvitjes në strukturat e FA, me synim arritjen e objektivave e të kapaciteteve dhe aftësive operationale të këtyre njësive dhe të FA në tërësi. Për vitet 2016-2025, stërvitja do të mbetet faktori kryesor për shndërrimin e një formacioni luftarak në një forcë të aftë dhe operationale.

Gjithashtu, mbështetja me resurse për gatishmërinë dhe mirëmbajtjen do të synojnë në rritjen e nivelit të gatishmërisë të strukturave të FA dhe rritjen e nivelit të mirëmbajtjes të sistemeve, pajisjeve dhe mjeteve për të mbajtur dhe arritur kapacitetet operacionale të kërkuara për realizimin e misionëve të ngarkuara për FA në tërësi dhe për çdo strukturë në veçanti.

Hartimi i listës së integruar të prioritetëve do të bëjë të mundur listimin e të gjitha projekteve të prioritarizuara në funksion të plotë të përmirësimit dhe të plotësimit të kushteve optimale të punës, stërvitjes, arsimit dhe kualifikimit për të gjitha strukturat e FA. Projektet kanë të bëjnë si me modernizimin e sistemeve dhe pajisjeve, ashtu dhe me sistemin infrastrukturor të FA.

Projektet kryesore në mbështetje të paketës së objektivave të kapaciteteve janë segmentuar në një mënyrë kronologjike dhe sigurojnë përdorimin më të mirë të burimeve të disponueshme.

#### **6.4.1 Kostoja e zhvillimit të kapaciteteve**

Përballimi financiar i PAZHFA 2016-2025 varet nga balancimi i kostos të projekteve të miratuara me projektet e planifikuara dhe të programuara e të mbështetura me buxhet. Për disa projekte, të cilat janë në fazë prokurimi, njihet kostoja reale dhe janë përcaktuar edhe detyrimet kontraktuale. Për projektet që ende nuk kanë arritur në fazën e implementimit apo nuk janë tenderuar, kostoja e përcaktuar pasqyron përlogaritje të përafërta të vlerës së projektit.

Përlogaritja e koston për projektet e planifikuara është bërë duke konsideruar të dhënat më të mira që zotërohen aktualisht, të cilat do të përditësohen në mënyrë sistematike. Për shkak të informacionit të kufizuar, pasi kostoja është objekt i kontratave, por edhe ndryshimeve të çmimeve dhe zhvillimeve teknologjike, përlogaritja e koston bëhet akoma më relative, sa më i largët të jetë afati i implementimit të projekteve. Si e tillë, ekziston një shkallë e caktuar pasigurie në lidhje me kostot e projekteve të përmendura në PAZHFA 2016-2025, të cilat nuk janë propozuar për miratim dhe tenderim.

Shtirja e programeve në vite do të reflektohet në varësi të mbështetjes financiare për FA, duke mbajtur në konsideratë prioritetet e përcaktuara.

### **LISTA E SHKURTIMEVE**

AFA – Akademia e Forcave të Armatosura

AISM – Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

ANO – Akademia e Nënoficerëve

ASNI - Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit

BE – Bashkimi Europian

C2 – Komandim-Kontrolli

C4I - Komandim, Drejtim, Komunikim, Kompjuterizim, Informimit (C4I)

CAOC – Qendra e Bashkuar e Operacioneve Ajrore

CIED – Kundër Pajisjeve Shpërthyesë të Improvizuara

CIMIC – Bashkëpunimi Civil-Ushtarak

CT – Objektivat e Kapaciteteve (*Capability Targets*)

EC – Emergjenca Civile

EOD – Asgjësimi i Municioneve të Rrezikshme Shpërthyesë

FA – Forcat e Armatosura

FAj – Forca Ajrore

FD - Forca Detare

FS – Forca Speciale

FT – Forca Tokësore

HNS - Vend Pritës (*Host Nation Support*)

IED – Pajisje Shpërthyesë të Improvizuara

IGJIU – Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake

KM – Komanda Mbështetëse

KDS – Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes

KL – Komplet Luftarak municioni  
 MADM – Mbrojtja nga Armët e Dëmtimit në Masë (CBRN)  
 MF – Ministria e Financave  
 MM – Ministria e Mbrojtjes  
 NATO – *North Atlantic Treaty Organisation*  
 NiA – Niveli i Ambicies  
 NATINAMDS - *NATO Integrated Air Missile Defense System*  
 NA5CRO – Operacione në përgjigje ndaj krizave, jashtë nenit 5  
 NSE – Elementët e Mbështetjes Kombëtare  
 NRF - *NATO Response Force*  
 VJTF- *Very High Readiness Joint Task Force*  
 OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

PAZHFA – Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura  
 PBB- Prodhimi i Brendshëm Bruto  
 PU – Policia Ushtarake  
 QBO – Qendra e Bashkuar Operacionale  
 QDK – Qendra e Doktrinës dhe Kërkimit  
 QKKSH – Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit  
 QKR – Qendra e Kontroll-Raportimit  
 QZH – Qendra e Zhytjeve  
 QMM – Qendra e Menaxhimit të Materialeve

QNOD – Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare  
 QSK – Qendra e Simulimit Konstruktiv  
 QVD – Qendra e Vëzhgimit Detar  
 QVA – Qendra e Vëzhgimit Ajror  
 RSM - Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes  
 SAC – Kapacitete të Transportit Strategjik të NATO-s (*NATO's Strategic Airlift Capability*)  
 SAR – *Search and Rescue* (Kërkim-Shpëtimi)  
 SVHA – Sistemi i Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore  
 SIVHD – Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare  
 SSK – Strategjia e Sigurisë Kombëtare  
 STANAG/AP – *Standard Agreement/ Alliance Publications*  
 SU - Strategjia Ushtarake  
 SHP – Shtabi i Përgjithshëm  
 SHT – Shkolla e Trupës  
 UAV – *Unmanned Air Vehicles*  
 UGV – *Unmanned Ground Vehicles*

<sup>i)</sup> Elementët kryesorë të fuqisë kombëtare konsiderohen Diplomacia, Informacioni, Fuqia Ushtarake dhe Ekonomia.

<sup>ii)</sup> The North Atlantic Treaty (1949) Washington D.C. - 4 April 1949 “In order more effectively to achieve the objectives of this Treaty, the Parties, separately and jointly, by means of continuous and effective self-help and mutual aid, will maintain and develop their individual and collective capacity to resist armed attack.”

<sup>iii)</sup> Neni 5 i Traktatit të Uashingtonit” (Article 5 “The Parties agree that an armed attack against one or more of them in Europe or North America shall be considered an attack against them all and consequently they agree that, if such an armed attack occurs, each of them, in exercise of the right of individual or collective self-defence recognised by Article 51 of the Charter of the United Nations, will assist the Party or Parties so attacked by taking forthwith, individually and in concert with the other Parties, such action as it deems necessary, including the use of armed force, to restore and maintain the security of the North Atlantic area. Any such armed attack and all measures taken as a result thereof shall immediately be reported to the Security Council. Such measures shall be terminated when the Security Council has taken the measures necessary to restore and maintain international peace and security.”)

<sup>iv)</sup> Niveli i Ambicies së Aleancës i vendosur në 2006, sipas, “*The DJSE Concept*,” nëpërmjet të cilit NATO-ja zhvilloi konceptin e Elementit të Dislokueshëm modular të Shtabit të Bashkuar (Deployable Joint Staff Element - DJSE), përcaktohet si kapacitetet e NATO-s për të siguruar njëherësh komandim-kontrollin për dy operacione të bashkuara madhore (*major joint operations*) të tillë si operacioni në Afganistan dhe gjashtë operacione të bashkuara të vogla (*smaller military operations*) të tillë si operacioni Active Endeavour në Mesdhe, (2MJO +4SJO).

<sup>v)</sup> Koncepti Strategjik i Aleancës, Lisbonë, Nëntor 2010, miratuar nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të 28 vendeve të

Aleancës.

<sup>vi)</sup> Termi “Kapacitet” nënkupton zhvillimin e aftësive luftarake të njësive të Forcave të Armatosura mbi bazën e 8 elementëve: Doktrinë, Organizim, Trajnim, Pajisje e Sisteme, Arsimim, Lidership, Personel, Infrastrukturë dhe Ndërveprim.

<sup>vii)</sup> Neni 5 i Traktatit të Uashingtonit” (Article 5 “The Parties agree that an armed attack against one or more of them in Europe or North America shall be considered an attack against them all and consequently they agree that, if such an armed attack occurs, each of them, in exercise of the right of individual or collective self-defence recognised by Article 51 of the Charter of the United Nations, will assist the Party or Parties so attacked by taking forthwith, individually and in concert with the other Parties, such action as it deems necessary, including the use of armed force, to restore and maintain the security of the North Atlantic area. Any such armed attack and all measures taken as a result thereof shall immediately be reported to the Security Council. Such measures shall be terminated when the Security Council has taken the measures necessary to restore and maintain international peace and security”).

<sup>viii)</sup> Kapacitete “Niche”, janë kapacitete të vogla të specializuara që kryejnë funksione të unifikuara në njësi shumëkombëshe. Këto kapacitete janë përtej njësive / formacioneve tradicionale. Ato krijohen nga vendet aleate mbi bazën e traditës, eksperiencës, veçorive dhe mundësive të tyre. Të tilla mund të përmendim ndër të tjera si ekipe EOD (asgjësimi i municioneve të rrezikshme), CIED (pajisje kundër eksplozivave të improvizuar), NBRC (masa kundër armëve të shkatërrimit në masë, nukleare, biologjike, radiologjike dhe kimike), OMLT (ekipe për trajnim dhe këshillim operacional) , POMLT (ekipe për trajnim dhe këshillim policor), CIMIC (marrëdhënie civilo ushtarake), MP (polici ushtarake), MAT (ekipe të këshillimit ushtarak) etj.







---

i Elementët kryesorë të fuqisë kombëtare konsiderohen Diplomacia, Informacioni, Fuqia Ushtarake dhe Ekonomia.

ii The North Atlantic Treaty (1949) Washington D.C. - 4 April 1949 “In order more effectively to achieve the objectives of this Treaty, the Parties, separately and jointly, by means of continuous and effective self-help and mutual aid, will maintain and develop their individual and collective capacity to resist armed attack.”

iii Neni 5 i Traktatit të Uashingtonit” (Article 5 “The Parties agree that an armed attack against one or more of them in Europe or North America shall be considered an attack against them all and consequently they agree that, if such an armed attack occurs, each of them, in exercise of the right of individual or collective self-defence recognised by Article 51 of the Charter of the United Nations, will assist the Party or Parties so attacked by taking forthwith, individually and in concert with the other Parties, such action as it deems necessary, including the use of armed force, to restore and maintain the security of the North Atlantic area. Any such armed attack and all measures taken as a result thereof shall immediately be reported to the Security Council. Such measures shall be terminated when the Security Council has taken the measures necessary to restore and maintain international peace and security .”)

iv Niveli i Ambicies së Aleancës i vendosur në 2006, sipas, “*The DJSE Concept*,” nëpërmjet të cilit NATO-ja zhvilloi konceptin e Elementit të Dislokueshëm modular të Shtabit të Bashkuar (Deployable Joint Staff Element - DJSE), përcaktohet si kapacitetet e NATO-s për të siguruar njëherësh komandim-kontrollin për dy



operacione të bashkuara madhore (*major joint operations*) të tillë si operacioni në Afganistan dhe gjashtë operacione të bashkuara të vogla (*smaller military operations*) të tillë si operacioni Active Endeavour në Mesdhe, (2MJO +4SJO).

<sup>v</sup> Koncepti Strategjik i Aleancës, Lisbonë, Nëntor 2010, miratuar nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të 28 vendeve të Aleancës.

<sup>vi</sup> Termi “Kapacitet” nënkupton zhvillimin e aftësive luftarake të njësive të Forcave të Armatosura mbi bazën e 8 elementëve: Doktrinë, Organizim, Trajnim, Pajisje e Sisteme, Arsimim, Lidërsip, Personel, Infrastrukturë dhe Ndërveprim.

<sup>vii</sup> Neni 5 i Traktatit të Uashingtonit” (Article 5 “The Parties agree that an armed attack against one or more of them in Europe or North America shall be considered an attack against them all and consequently they agree that, if such an armed attack occurs, each of them, in exercise of the right of individual or collective self-defence recognised by Article 51 of the Charter of the United Nations, will assist the Party or Parties so attacked by taking forthwith, individually and in concert with the other Parties, such action as it deems necessary, including the use of armed force, to restore and maintain the security of the North Atlantic area. Any such armed attack and all measures taken as a result thereof shall immediately be reported to the Security Council. Such measures shall be terminated when the Security Council has taken the measures necessary to restore and maintain international peace and security”).

<sup>viii</sup> Kapacitete “Niche”, janë kapacitete të vogla të specializuara që kryejnë funksione të unifikuara në njësi shumëkombëshe. Këto kapacitete janë përtej njësive/formacioneve tradicionale. Ato krijohen nga vendet aleate mbi bazën e traditës, eksperiencës, veçorive dhe mundësive të tyre. Të tilla mund të përmendim ndër të tjera si ekupe EOD (asgjësimi i municioneve të rrezikshme), CIED (pajisje kundër eksplozivave të improvizuar), NBRC (masa kundër armëve të shkatërrimit në masë, nukleare, biologjike, radiologjike dhe kimike), OMLT (ekupe për trajnim dhe këshillim operacional), POMLT (ekupe për trajnim dhe këshillim policor), CIMIC (marrëdhënie civilo ushtarake), MP (polici ushtarake), MAT (ekupe të këshillimit ushtarak), etj.